



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 14 (827869)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 prill 2024

Bashkë më të fortë



Mesazhi i Presidentit të Republikës: Data e 1 prillit të vitit 2009 jetësoi vizionin Euroatlantik të shqiptarëve për të qenë pjesë e Aleancës politiko-ushtarake më të fuqishme të kohës sonë.



Kryeministri Rama: Ky 15-vjetor i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO nuk është vetëm një festë e arritjeve tona të së shkuarës, por edhe një riafirmim i përkushtimit tonë të palëkundur ndaj parimeve dhe vlerave që mbështesin Aleancën tonë.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Shpreh qëndrimin e palëkundur të qeverisë shqiptare për të vijuar rrugëtimin e përbashkët drejt një të ardhmeje të sigurt. Krenarë që jemi pjesë e kësaj historie.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji: Krenar që Shqipëria është një vend aleat i besueshëm, promovues dhe mbrojtës i paqes, vlerave demokratike dhe sigurisë kolektive.

Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit mes Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtimit dhe Tirana International Airport

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit midis Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Tirana International Airport sh.p.k. (TIA): "Për bashkëpunimin në operacionet e kërkim - shpëtimit në zonën e përgjegjesisë së TIA".

Ky memorandum shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit (Search And Rescue - SAR) në zonën e përgjegjesisë së TIA.

Duke u nisur nga Marrëveshja e Koncesionit që i jep TIA të drejtën dhe autoritetin për menaxhimin dhe operimin e aeroportit, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje konfirmohet vullneti i dy palëve për të përmirësuar sigurinë teknike dhe reagimin e shpejtë në rastet e emergjencave të SAR në këtë zonë të aeroportit.

Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, TIA dhe QKKSH zotohen për zbatimin e kushteve të përcaktuara në të dhe për koordinim të vazhdueshëm për çdo ndryshim operacional, që mund të ndikojë në operacionet e SAR në këtë zonë të rëndësishme të aeroportit.

Ky bashkëpunim reflekton përkushtimin e të dyja palëve për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe vizitorëve të aeroportit, duke u nisur nga përgjegjësia dhe detyrimi për t'u përgjigjur në mënyrë të shpejtë dhe efektive në situata emergjente të SAR.



Baza e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile mirëpriti sot në ambientet e saj nxënësit e shkollës së mesme "Aleks Buda", Tiranë

Në kuadër të aktiviteteve promovuese të fushatës së rekrutimit të të rinjve në Forcat e Armatosura, nxënës të shkollës së mesme "Aleks Buda", Tiranë zhvilluan një vizitë njohëse në mjediset e BMEC. Nxënësit u pritën nga komandanti i BMEC, kolonel Hajdar Gurra, i cili në fjalën e tij përshëndetëse u uroi mirëseardhjen dhe u foli të rinjve për misionin fisnik të BMEC, duke ndarë me ta jo vetëm kontributin e këtij reparti, operacionet brenda vendit por dhe ato jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandantë të reparteve vartëse të Komandës Mbështetëse dhe përfaqësues nga Qendra e Personel Rekrutimit.

Nxënësit e shkollës së mesme "Aleks Buda", u njohën me ambientet, teknikën, pajisjet speciale dhe materiale të ndryshme, të cilat janë në përdorim nga BMEC. Gjithashtu nëpërmjet stendave të ekspozuara nxënësit morën informacion në lidhje me aktivitetin e realizuar ndër vite nga nënrepartet e Komandës Mbështetëse.

Aktiviteti vijoi me një demonstrim ushtrimi nga efektivet e kompanisë së parë dhe të dytë operacionale, demonstrimin e një situatë të fikjes së zjarrit në ambiente të mbyllura dhe të hapura si dhe një ushtrimi kompleks kërkim-shpëtimi malor (hedhje nga lartësia dhe zbritja e të plagosurit nga lartësitë). Në këto demonstrime u përdorën pajisje dhe teknika moderne. Përfaqësuesit e Qendrës së Personel Rekrutimit shpërndanë broshura me materiale informuese për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Në përfundim të aktivitetit u realizua një foto e përbashkët midis ushtarakëve dhe nxënësve të pranishëm.



Nxënësit e shkollës së mesme "Aleks Buda", u njohën me ambientet, teknikën, pajisjet speciale dhe materiale të ndryshme, të cilat janë në përdorim nga BMEC. Gjithashtu nëpërmjet stendave të ekspozuara nxënësit morën informacion në lidhje me aktivitetin e realizuar ndër vite nga nënrepartet e Komandës Mbështetëse.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"



Kryeministri Rama: Ambicia jonë brenda vitit 2030, të kemi eksporte ushtarake 'Made in Albania' dhe ushtria jonë të fillojë të pajiset me mjete ushtarake të markës 'Made in Albania'

Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes filloi aktivitetin e saj me një ceremoni prezantimi të rëndësishme dhe aktivitetit që ka kjo qendër për Forcat e Armatosura dhe jo vetëm. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministra të kabinetit, deputetë dhe drejtues të lartë të FA-së, të cilët vizituan mjediset e kësaj qendre, ku u njohën me funksionet e secilës prej godinave.

Gjatë ceremonisë së zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, e cilësoi këtë si një hapje të një faqeje të re në Forcat e Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

“Është një faqe modernizimi, është një kalim në një fazë të re të zhvillimit të Shqipërisë që po i bashkohemi edhe ne. Është mishërim i vizionit të kryeministrit Rama për futjen e zhvillimeve në Shqipëri në lëvizjen për inovacion”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi: “Një vend me zhvillim si Shqipëria ka nevojë për të kapërcyer dhe për të rritur ritmin me ndihmën e teknologjive të reja, me ndihmën e fuqisë intelektuale të kombit shqiptar. Ndaj ne sot jemi krenarë që i bashkohemi kësaj lëvizjeje dhe premtojmë që shumë shpejt do të japim produktet e para inovative, që do të jenë edhe model frymëzues besoj për të rinjtë shqiptarë që na janë bashkuar në Forcat e Armatosura, por edhe për të rinjtë e tjerë që të kuptojnë që e ardhmja mund të ndërtohet këtu”.

Ministri i Mbrojtjes tha se kjo qendër është pjesë e rrjetit të qendrave të ekselencës së NATO-s, duke qenë se Shqipëria është vend anëtar. “Qendrat e ekselencës së NATO-s, si anëtarë të Aleancës janë qendrat tona të ekselencës. Jemi pjesë e një network-u, që ndërveprojmë, rrisim kapacitetet tona të trajnimit, jemi në kontakt me të rejtat e fundit të inteligjencës artificiale, teknologjive të reja, të cilat kanë për qëllim të na ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve tona të sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërtojmë më shumë fuqi mbrojtëse me më pak burime”, - u shpreh ministri Peleshi. Sipas ministrit Peleshi, në këtë qendër trajnohet modeli shqiptar i inteligjencës artificiale, duke përdorur dy satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2” dhe flotiljen e dronëve “Bayraktar”, imazhet e të cilëve analizohen sipas interesave të sektorëve.



Në fjalën e tij Kryeministri Edi Rama përgëzoi ministrinë e Mbrojtjes për punën e bërë dhe tha se Qendra e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes hap një tjetër faqe në modernizimin e ushtrisë shqiptare. Kryeministri Rama theksoi se: “Për t’iu përgjigjur sfidave të reja dhe nivelit të ri të angazhimit që kemi në bazë të vizionit tonë për Forcat e Armatosura të Shqipërisë 2030, një strategji e re ushtarake dhe një plan i ri i

zhvillimit afatgjatë të Forcave të Armatosura janë tanimë gati dhe do t’i nënshtrohen procesit të ligjvënies në Kuvend. Ndërkohë që po përgatitim edhe platformën e re të zhvillimit të industrisë ushtarake. Ambicia jonë është që brenda vitit 2030 ne të kemi edhe eksporte ushtarake ‘Made in Albania’ dhe nga ana tjetër sigurisht që ushtria jonë do të fillojë të pajiset edhe me mjete ushtarake të markës Made in Albania”, - u shpreh kryeministri,

duke theksuar vijimin e mbështetjes për efektivitetin e FA-së. Nëpërmjet Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, e cila i bashkëngjitet Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, synohet ndër të tjera të forcohen kapacitetet kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes përmes zbatimit të projekteve inovative dhe integritit të teknologjive të avancuara, si dhe të nxitet zhvillimi i një ekosistemi të inovacionit në siguri dhe mbrojtje.

75 vite NATO

Kur dhe pse lindi NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, NATO, lindi më 4 prill 1949, kjo është dita në të cilën, në Uashington, u nënshkrua "Pakti Atlantik", mbrojtja themeluese e NATO-s.

Ai u nënshkrua nga përfaqësues të 12 vendeve: Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Norvegjia, Holanda, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Konteksti i krijimit të NATO-s ishte ai i Luftës së Ftohtë, i dominuar nga dy blloqe të mëdha kundërshtarë, ai lindor i formuar nga Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tij satelitore, dhe ai perëndimor, i udhëhequr nga SHBA-të dhe që përfshinte vendet që nënshkruan marrëveshjen.

Duke filluar nga viti 1953, krerët e saj zgjodhën si stemë një trëndafil ere me katër vija, një për çdo pikë kardinal, që simbolizonte rrugët ideale drejt paqes (të gjitha në një sfond blu, një aludim për Oqeanin Atlantik, emblemë e bashkimit midis Amerikës dhe Evropës.

"Qëllimi i NATO-s është të mbajë amerikanët brenda aleancës, rusët jashtë dhe gjermanët nën kontroll", deklaroi në atë kohë Sekretari i Përgjithshëm i saj, Hastings Lionel Ismay në detyrë nga viti 1954 deri në 1957.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të donin të siguronin një prani ushtarake në arenën evropiane, në një çelës anti-rus, kontroll mbi Gjermaninë – përgjegjëse për konfliktin, e cila nga viti 1949 u nda në Gjermaninë Perëndimore dhe Lindore.

Qëllimi i NATO-s

Traktati i Atlantikut të Veriut (NATO) ishte kryesisht i fjetur derisa Lufta Koreane nisi krijimin e NATO-s për ta zbatuar atë, me anë të një strukture të integruar ushtarake, kjo përfshinte formimin e Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në 1951, i cili miratoi Strukturat dhe planet ushtarake të Western Union, duke përfshirë STANAG-të dhe SOFA-të dypalëshe. Në vitin 1952, u vendos posti i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, si shefi civil i organizatës. Atë vit u zhvilluan gjithashtu stërvitjet e para të mëdha detare të NATO-s, Ushtrimet "Mainbrace" dhe pranimiti i Greqisë dhe Turqisë në organizatë. Pas Konferencave të Londrës dhe Parisit, Gjermanisë Perëndimore iu lejua të riarmatosej ushtarakisht, pasi ajo u bashkua me NATO-n në maj 1955, e cila ishte, nga ana tjetër, një faktor kryesor në krijimin e Traktatit të Varshavës të dominuar nga sovjetikët, duke përcaktuar dy anët kundërshtarë të Luftës së Ftohtë.

Ndërtimi i Murit të Berlinit në vitin 1961 shënoi një kulm në tensionet e Luftës së Ftohtë, kur 400 000 trupa amerikane u vendosën në Evropë. Dyshimet mbi fuqinë e marrëdhënieve midis shteteve evropiane dhe Shteteve të Bashkuara u zbehën dhe rrodhën, së bashku me dyshimet mbi besueshmërinë e mbrojtjes së NATO-s kundër një pushtimi të mundshëm sovjetik, dyshime që çuan në zhvillimin e parandalimit të pavarur bërthamor francez dhe tërheqjes të Francës nga struktura ushtarake e NATO-s në vitin 1966. Në vitin 1982, Spanja iu bashkua aleancës. Revolucionet e vitit 1989 në Evropë çuan në një rivlerësim strategjik të qëllimit, natyrës, detyrave dhe fokusit të NATO-s në atë kontinent.

Në tetor 1990, Gjermania Lindore u bë pjesë e Republikës Federale të Gjermanisë dhe aleancës, dhe në nëntor 1990, aleanca nënshkroi Traktatin për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë (CFE) në Paris me Bashkimin Sovjetik. Ai urdhëroi reduktime specifike ushtarake në të gjithë kontinentin, të cilat vazhduan pas rënies së Paktit të Varshavës në shkurt 1991 dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në atë dhjetor, i cili largoi kundërshtarët kryesorë de facto të NATO-s. Kjo filloi një tërheqje të shpenzimeve dhe pajisjeve ushtarake në Evropë. Traktati CFE lejoi nënshkruarit të hiqnin 52 000 pjesë të armatimeve konvencionale në gjashtëmbëdhjetë vitet e ardhshme, dhe lejoi që shpenzimet ushtarake nga anëtarët evropianë të NATO-s të bien me 28% nga 1990 deri në 2015.

Në vitet 1990, organizata i zgjeroi aktivitetet e saj në situata politike dhe humanitare që nuk kishin qenë më parë shqetësime të NATO-s. Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, organizata kreu ndërhyrjet e para ushtarake në Bosnje nga viti 1992 deri në 1995 dhe më vonë në Jugosllavi në vitin 1999. Këto konflikte motivuan një ristrukturim të madh ushtarak të pas Luftës së Ftohtë. Struktura ushtarake e NATO-s u shkurtua dhe u riorganizua, me forca të reja, të tilla si Korpusi i Reagimit të Shpejtë të Komandës



Aleate të Shtabit të Evropës. Ndryshimet e shkaktuara nga kolapsi i Bashkimit Sovjetik në ekuilibrin ushtarak në Evropë që nga traktati CFE u njohën në Traktatin e Forcave të Armatosura Konvencionale të Përshtatura në Evropë, i cili u nënshkrua në samitin e Stambollit të vitit 1999.

Politikisht, organizata kërkoi marrëdhënie më të mira me vendet e reja autonome të Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe forume diplomatike për bashkëpunimin rajonal midis NATO-s dhe fqinjëve të saj u krijuan gjatë kësaj periudhe të pas Luftës së Ftohtë, duke përfshirë nismën e Partneritetit për Paqe dhe Dialogut Mesdhetar në 1994, Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik në 1997 dhe Këshilli i Përhershëm i Përbashkët NATO-Rusi në 1998. Në samitin e Uashingtonit të vitit 1999, Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke u bashkuan zyrtarisht në NATO dhe organizata gjithashtu nxori udhëzime të reja për anëtarësimin në "Plane Veprimi për Anëtarësim" të individualizuara. Këto plane rregulluan shtimin e anëtarëve të rinj të aleancës: Bullgaria,

Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia në 2004, Shqipëria dhe Kroacia në 2009, Mali i Zi në 2017 dhe Maqedonia e Veriut në 2020. Zgjedhja e Presidentit francez Nicolas Sarkozy në 2007 çoi në një reformë të madhe të pozicionit ushtarak të Francës, duke kulmuar me kthimin në anëtarësimin e plotë më 4 prill 2009, e cila përfshinte gjithashtu ribashkimin e Francës në Strukturën e Komandës Ushtarake të NATO-s, duke ruajtur një pengesë të pavarur bërthamore.

Neni 5 i traktatit të Atlantikut të Veriut, që kërkon që shtetet anëtare t'i vijnë në ndihmë çdo shteti anëtar që i nënshtrohet një sulmi të armatosur, u thirr për herë të parë dhe të vetme pas sulmeve të 11 shtatorit, pas së cilës trupat u vendosën në Afganistan, nën ISAF të udhëhequr nga NATO. Organizata ka operuar një sërë rolesh shtesë që atëherë, duke përfshirë dërgimin e trajnerëve në Irak, ndihmën në operacionet kundër piraterisë dhe në vitin 2011, zbatimin e një zone ndalim-fluturimi mbi Libi në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të



Mesazhi i Presidentit të Republikës:
“Data e 1 prillit të vitit 2009 jetësoi vizionin Euroatlantik të shqiptarëve për të qenë pjesë e Aleancës politiko-ushtarake më të fuqishme të kohës sonë. Ky anëtarësim realizoi aspiratën e kahershme të popullit shqiptar, duke e kthyer atë te përkatësia e vet perëndimore, e mishëruar që në filozofinë e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, si strateg i aleancës së parë politiko-ushtarake me Perëndimin. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është një ndër datat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Mirënjohës ndaj popullit shqiptar, SHBA-ve dhe aleatëve, të cilët mundësuan realizimin e këtij anëtarësimi. Shqipëria në këto 15 vite në NATO ka sjellë më shumë siguri për vendin, rajonin dhe hapësirën Euroatlantike. Krenar për efektivet e Forcave tona të Armatosura, si dhe vajzat e djemtë shqiptarë në misionet paqeruajtëse dhe operacionet e NATO-s, si: Afganistan, Irak, Bosnjë, Kosovë, Bullgari, Letoni dhe Deti Egje. Shqipëria do të vijojë të jetë e palëkundur që, së bashku me aleatët, të mbrojtë lirinë e të kontribuojë për një botë në paqe.”

Kryeministri Rama: “Ky 15-vjetor i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO nuk është vetëm një festë e arritjeve tona të së shkuarës, por edhe një riafirmim i përkushtimit tonë të palëkundur ndaj parimeve dhe vlerave që mbështesin Aleancën tonë. Gjatë 15 viteve të fundit, Shqipëria ka kontribuar me krenari në mbrojtjen kolektive dhe sigurinë e NATO-s, dhe ne mbetemi të palëkundur në përkushtimin tonë për të mbështetur paqen dhe vlerat demokratike në të gjithë rajonin tonë dhe më gjërë”.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “15 vjet më parë Shqipëria u bë zyrtarisht anëtare me të drejta të plota e Aleancës më të fortë politiko-ushtarake të NATO-s. Në këtë përvjetor ajo qëndron e palëkundur në misionin e saj krahas SHBA-ve dhe aleatëve e partnerëve të saj, në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në Botë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shpreh qëndrimin e palëkundur të qeverisë shqiptare për të vijuar rrugëtimin e përbashkët drejt një të ardhmeje të sigurt. Krenarë që jemi pjesë e kësaj historie. Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike do të vazhdojë të mbetet i pandryshuar”, - shprehet Ministri Peleshi në mesazhin e tij me rastin e përvjetorit të 15-të të anëtarësimit në NATO. Ministri Peleshi e konsideron anëtarësimin e Shqipërisë në NATO një moment historik dhe dëshmi të dedikimit të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. “Në këto vite, vendi ynë ka treguar përkushtim të palëkundur ndaj vlerave të Aleancës dhe ka kontribuar në misionet e paqes dhe sigurisë nëpër botë. Mirënjohje të gjithë efektiveve të Forcave të Armatosura për kontributin dhe angazhimin tuaj për të bërë këtë rrugë të mundur. Vazhdojmë të punojmë për një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme për të gjithë”, - tha Peleshi. Me pjesëmarrjen e efektiveve më të mirë të Forcave të Armatosura në misionet ndërkombëtare, Shqipëria i është bashkuar përpjekjeve të Aleancës për të përballuar sfidat e sigurisë, duke u vlerësuar si një aleatë dinjitoze e NATO-s. Në përmbushje të detyrimeve ndaj Aleancës, Shqipëria ka rritur ndjeshëm mbështetjen buxhetore për mbrojtjen, duke arritur objektivin 2 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe vijon modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve brenda Forcave të Armatosura. Gjithashtu, më 4 mars 2024, u inaugurua baza taktike ajrore e NATO-s në Kuçovë, e cila do të jetë në funksion të misioneve të NATO-s, si pika e vetme strategjike e Aleancës në Ballkanin Perëndimor.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji:
“Krenar që Shqipëria është një vend aleat i besueshëm, promovues dhe mbrojtës i paqes, vlerave demokratike dhe sigurisë kolektive. Përgjatë shumë viteve jemi angazhuar dhe vijojmë të kontribuojmë në një sërë misionesh të drejtuara nga NATO, BE e OKB, krahas partnerëve dhe aleatëve strategjikë. Ky përvjetor i gjen Forcat e Armatosura në një proces transformimi dhe modernizimi që nga rishikimi i dokumenteve strategjike, implementimi i projekteve të reja me fokus rritjen e kapaciteteve operacionale, fuqisë së zjarrit, mbrojtjen kundërajrore dhe kibernetike, për t'i përmbushur më së miri detyrimet kombëtare dhe ndaj Aleancës. Në këtë epokë të karakterizuar nga sfida komplekse të sigurisë, ku po cenohen vlerat e lirisë dhe demokracisë, NATO është më e bashkuar dhe më e fortë se kurrë!”.

OKB-së 1973. Neni 4, i cili thjesht thirret në konsultim ndërmjet anëtarëve të NATO-s, është thirrur pesë herë pas incidenteve në Luftën e Irakut, Luftës Civile Siriane dhe aneksimit të Krimesë nga Rusia. Ky aneksion çoi në dënimin e fortë nga vendet e NATO-s dhe krijimin e një force të re “majë shtize” prej 5000 trupash në bazat në Estoni, Lituani, Letoni, Poloni, Rumania dhe Bullgari. Në samitin pasues të Uellsit të vitit 2014, udhëheqësit e shteteve anëtare të NATO-s u zotuan zyrtarisht për herë të parë që të shpenzonin ekuivalentin e të paktën 2% të prodhimit të tyre të brendshëm bruto për mbrojtjen deri në vitin 2024, që më parë kishte qenë vetëm një udhëzues joformal. Në vitin 2014, vetëm 3 nga 30 anëtarë të NATO-s arritën këtë objektiv (përfshirë SHBA-në); deri në vitin 2020 kjo ishte rritur në 11. Të marra së bashku, në vitin 2020, 29 shtetet jo-anëtare të SHBA-së patën gjashtë vite radhazi rritje të shpenzimeve të mbrojtjes, duke e çuar shpenzimin e tyre mesatar në 1.73% të PBB-së. Anëtarët e NATO-s i kanë rezistuar Traktatit të Ndalimit të Armëve Bërthamore të OKB-së, një marrëveshje detyruese për negociatat për eliminimin total të armëve bërthamore, e mbështetur nga më shumë se 120 vende.

15 vite, Shqipëria në NATO

Gjatë viteve '80, Shqipëria ishte vendi më i izoluar i Evropës dhe pas rënies së Murit të Berlinit, strehë e rrënojës së fundit të komunizmit e diktaturës staliniste në kontinent. Deri në vitin 1990, aleanca e fundit ushtarake, pjesë e së cilës kishte qenë vendi ynë, ishte Traktati i Varshavës, anëtarët e të cilit përbëheshin nga të gjitha vendet e bllokut komunist të Evropës Lindore

(me përjashtim të Jugosllavisë) dhe që udhëhiqej nga Bashkimi Sovjetik. Shqipëria ishte anëtarësuar në këtë aleancë në vitin 1955, për t'u shkëputur më pas përfundimisht në vitin 1968, pas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me këtë të fundit. Pas përmbysjes së regjimit komunist, Shqipëria iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, organizëm i krijuar nga NATO me qëllim rindërtimin e marrëdhënieve me vendet e dala nga Traktati i Varshavës.

Dy vite më vonë, më 23 shkurt 1994, Presidenti i Shqipërisë asokohe, nënkroi Marrëveshjen e Partneritetit për Paqe mes NATO-s dhe vendeve të ish-bllokut komunist dhe paraqiti po në të njëjtën ditë, kërkesën zyrtare të Shqipërisë për t'u bashkuar Aleancës. Kështu, në 1999, Shqipërisë iu dërgua Plani i Veprimit për Anëtarësimin, vendet anëtare të NATO-s nënkruan Protokollin e Anëtarësimit për Shqipërinë dhe Kroacinë, në Samitin e Bukureshtit të mbajtur, më 2 prill 2008, dhe Shqipëria filloi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit, më 25 prill të po këtij viti.

Reformat e gjithanshme, të zbatuara me sukses, në kuadër të ratifikimit të protokollit, bënë që më 1 prill 2009, Shqipëria të anëtarësohej në strukturat e Aleancës, duke shënuar kështu një prej arritjeve më të mëdha historike për vendin, si dhe përmbushjen e një prej objektivave madhore të politikës së jashtme dhe sigurimit e avancimit të interesave kombëtare. Statusi i Shqipërisë, si vendi i parë ish-komunist që kishte shprehur haptazi dhe qartë, nëpërmjet një kërkesë zyrtare,

vullnetin për anëtarësim në NATO, i dha asaj një rol të veçantë strategjik në Evropën Lindore, si një shtet, që megjithëse i vogël, kishte arritur të vendoste një trend të ri gjeopolitik për këtë pjesë të kontinentit.

Modernizimi i forcave të armatosura Shqiptare

Avantazhet më të mëdha dhe më të frytshme të bashkëpunimit të Shqipërisë me Aleancën e Atlantikut të Veriut, janë pa dyshim ato të fuqizimit ushtarak, modernizimit të teknologjisë ushtarake, si dhe forcimit e reformimit të institucioneve të mbrojtjes. Duke iu përgjigjur detyrimeve të vendit si aleat ndaj NATO-s, Forcat e Armatosura Shqiptare janë dërguar përgjatë 15 viteve të fundit për të kontribuar në një sërë misionesh të rëndësishme paqeruajtëse në Afganistan, Detin Egje, Irak, etj. Më 4 mars të këtij viti, u përrua baza e parë taktike ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ajo e Kuçovës. Ky projekt nisi në janar të dy viteve më parë dhe kushtoi rreth 45,8 milionë euro. Vendimi i Aleancës për të ndërtuar këtë bazë, pikërisht në Shqipëri, forcon jo vetëm bashkëpunimin mes saj e vendit tonë, por thekson gjithashtu edhe rolin strategjik ushtarak të Shqipërisë si aleati më i rëndësishëm i Perëndimit në rajon.

Statusi i vendit anëtar të NATO-s, dhe së fundmi edhe ai i vendit kandidat në Bashkimin Europian, i japin Shqipërisë një pozicion të veçantë në kuadër të forcimit të sigurisë në Evropën Juglindore, në mbështetje të linjës politike të koordinimit të ngushtë mes Aleancës dhe Unionit, përballë kërcënimeve në rritje nga shtete me synime ekspansioniste, siç është Rusia. Sulmi në Ukrainë, i dënuar me ashpërsi nga NATO, ngriti së fundmi alarmin për sigurinë në Evropë, duke theksuar nevojën e rritjes së shpenzimeve qeveritare për mbrojtjen, për të arritur objektivin prej 2% të PBB (Prodhimit të Brendshëm Bruto), të miratuar unanimisht nga të gjitha vendet aleate në vitin 2014.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg u ka bërë së fundmi thirrje 18 vendeve aleate që nuk e kanë arritur akoma këtë objektiv, për t'u kujdesur për përmbushjen e tij deri në fund të këtij viti.

Duke pasur parasysh rritjen e influencës së Rusisë në Ballkan, të dhënat e raportit duhet të jenë kampion alarmi për Shqipërinë si aleat kryesor i NATO-s dhe Perëndimit në këtë rajon delikat.

Në këtë 15-vjetor të udhëtimit të përbashkët nga Ambasda e SHBA-së në Tiranë duke e vlerësuar si ‘një aleatë dhe partnerë të besueshëm’ vjen urimi “15 Vite së Bashku, Udhëtimi i Shqipërisë me NATO-n. Që nga anëtarësimi në NATO në 2009, zhvillimi i Shqipërisë në një partner dhe aleat të besueshëm ka qenë vërtet i jashtëzakonshëm”.



STATUSI I VENDIT ANËTAR TË NATO-S, DHE SË FUNDMI EDHE AI I VENDIT KANDIDAT NË BASHKIMIN EUROPIAN, I JAPIN SHQIPËRISË NJË POZICION TË VEÇANTË NË KUADËR TË FORCIMIT TË SIGURISË NË EVROPËN JUGLINDORE, NË MBËSHTETJE TË LINJËS POLITIKE TË KOORDINIMIT TË NGUSHTË MES ALEANCËS DHE UNIONIT, PËRBALLË KËRCËNIMEVE NË RITJE NGA SHTETE ME SYNIME EKSPANSIONISTE, SIÇ ËSHTË RUSIA. SULMI NË UKRAINË, I DËNUAR ME ASHPËRSI NGA NATO, NGRITI SË FUNDMI ALARMIN PËR SIGURINË NË EVROPË, DUKE THEKSUAR NEVOJËN E RITJES SË SHPENZIMEVE QEVERTARE PËR MBROJTJEN, PËR TË ARRITUR OBJEKTIVIN PREJ 2% TË PBB (PRODHIMIT TË BRENDSHËM BRUTO), TË MIRATUAR UNANIMISHT NGA TË GJITHA VENDET ALEATE NË VITIN 2014.



Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në ceremoninë e 50 - vjetorit të krijimit të Bazës Detare të Sarandës.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm personalitete të pushtetit vendor e lokal, kryetari i Bashkisë Sarandë, z. Oltion Çaçi, kryetari i Shoqatës Detaria Shqiptare, ish - komandantë të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, ish - efektive dhe punonjës civilë që kanë shërbyer në Bazën Ushtarake Detare Shëngjin, Qendra e Personel Rekrutimit me personelin e saj, gjatë së cilës dhanë informacion më shumë ndaj të rinjve për t'u bashkuar në radhët e Forcave të Armatosura të RSH si një mundësi për të ardhmen.

Ceremonia vijoi me dhënie të certifikatave të mirënjohjes për kontributin e dhënë në Forcën Detare/Rojën Bregdetare nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnand Agastra, si dhe me ekspozitën fotografike në Galerinë Art Saranda, ku u shfaq një dokumentar historik, duke përmbyllur këtë ditë të veçantë me kujtime dhe respekt për traditën detare të këtij qyteti.

Aktiviteti u zbulua nga nxënësit e shkollës 9-vjeçare "9 Tetori", që kishin përgatitur një program të shkurtër artistik në këtë ditë të veçantë në përkujtim të detarëve të qytetit të Sarandës.

Në shëtitoren e qytetit të Sarandës u vendos pllaka me emrin "Marinari" në përkujtim dhe nderim të të gjithë personelit që kanë shërbyer në Bazën Ushtarake Detare Sarandë.



Anija shqiptare "Lissus" në misionin "Sea Guardian" në detin Egje vijon kontributin në parandalimin e emigracionit të paligjshëm në ujërat e Aleancës. Ekuipazhi shqiptar, gjatë lundrimit në rajonin e patrullimit, konstatoi një gomone me 24 persona në bord, të cilën pas koordinimit me rojën bregdetare turke e greke, ia dorëzoi autoriteteve lokale për procedurat e mëtejshme.



Ekipi i kërkim-shpëtimit së bashku me helikopterin e Emergjencave Civile në Ministrinë e Mbrojtjes u angazhuan menjëherë sapo kanë marrë njoftimin, krahe policisë së Tropojës, në ndihmë të një grupi alpindin e quajtur "Maja e Jezercës".

Fatkeqësisht njëra nga anëtarët e grupit, shtetasja Z.L, 43 vjeç kishte rënë nga një terren i thepisur malor dhe me borë dhe si pasojë ka humbur jetën.

Ekipi i kërkim-shpëtimit ka bërë të mundur nxjerrjen e trupit të pajetë dhe transportimin me helikopter drejt morgut. Ndërsa operacioni i shpëtimit ka vijuar duke bërë të mundur nxjerrjen e turistëve të tjerë, nga vendi ku ishin bllokuar.

Edhe sa 'Aurelio' akoma?!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Apel në emër të jetës

Edhe sa akoma?, është pyetja që dhimbshëm del nga shpirti i një nëne, motre, mike.

Aurelio, biri i një nëne që i thau syrin, i riu që copëtoi zemrat e të gjithëve, 'fenomeni i realitetit të zi'.

Pyetja që na është kthyer në refrenin e çdo dite, sapo mediat transmetojnë kronikën e zezë. Një 15-vjeçar, 18-vjeçar, një ... vjeçar, u vra nga tjetër bashkëmoshatar i tij.

Po ku duhet ta kërkojmë fajtorin, në rrugë, në shkollë, në shoqëri?

Mos vallë e gjitha ndodh nga mungesa e kulturës, formës së komunikimit, mirëkuptimit mes palëve brenda familjeve shqiptare. Ata janë fëmijë... dhe kjo botë e ekspozuar, pa filtra i ka bërë të keqkuptojnë realitetin nga efektet e AI-së, nga iluzioni aq i bukur i një optike të verbër nga luksi dhe bukuritë 'fake'. Të ndezura nga jeta virtuale, marrin flakë shpesh nga një follow, një emoji, një kompliment ndaj një fotografie, një sharje, një lidhje e pa aprovuar, një ndarje e papranuar. Bullizëm, persistencë për t'u shfaqur superior ndaj bashkëmoshatarëve, 'gjasme më i rritur, gjasme më i fortë, gjasme më i zgjuar'. Ose më keq akoma grinden për territore, ku çdonjëri përpiqet të konfirmohet se po bëhet një burrë, se është mjaftueshëm i zoti të mposhtë. Por është vetëm një fëmijë... Ahhh veç një fëmijë!

Shpesh ata kërkojnë të bëjnë të fortin dhe kjo si një dëshirë për t'u dalluar nga të tjerët, për të qenë ndryshe, 'origjinal' në mendime, fjalë dhe veprime. Ai kërkon të zbulojë rrugët që i duken të drejta për të qenë sa më interesant në sytë e të tjerëve, të tërheqë vëmendjen drejt tij. Pa këto zhurma të hareshme nuk mund të kuptohet dot jeta e adoleshentëve.

Nëse do t'i kthehemi realiteteve të shkollës, pas emrit të çdo nxënësi, pas numrit rendor në regjistër, pas çdo note, është një adoleshent me botën e tij shpirtërore në formim, i brishtë, që ka nevojë të orientohet, të nxitet e të mësojë, edhe pse ai për veten e tij thotë se "i di të gjitha dhe s'ka asgjë për të mësuar". Por ai ndihet keq kur ndjen indiferentizëm ndaj tij, kur nuk e përfillin dhe nuk tregojnë interes për të. Ai ndihet keq kur nuk di se ç'të bëjë, kur nuk ka motive në jetë.

Në kësi rastesh për adoleshentët, një ditë nuk ndryshon nga një ditë tjetër, një muaj nuk ndryshon nga një muaj tjetër: "Ah, gjithnjë të njëjtat gjëra! Sa e mërzitshme është kjo jetë!". Adoleshentët fillojnë e bëhen melankolikë, mbyllën në vetvete, bien në pesimizëm, në dëshpërim të thellë. Dhe ky është çasti më i rrezikshëm, sepse ata përpiqen të gjejnë ngushëllim dhe zgjidhje, duke hedhur vështrimin nga rruga, që i tërheq si "gjarpër i keq". Më shumë fëmijë sesa adoleshentë, zbrasin të mllefosur nga mjetet, njëri me makinë më të mirë se tjetri. (Prindër po investoni në mënyrë të pavullnetshme, të ndodhin tragjedi të tilla).

Ky i dyti, që pas pak nuk do buzqeshë më, quhet Aureljo. I pari një 16-vjeçar që shoqërohet nga shokët, ardhur nga Kalaja e Dodës jeton në zonën e Farkës, në shtëpi private dhe duhet thënë ekonomikisht nuk i ka munguar asgjë. Megjithatë kjo nuk i ka dhënë aq siguri saqë të jetë i bindur se konfliktet sqarohen me diskutim, ose nuk sqarohen fare.

Jo, ai është më i sigurt me një thikë të fshehur në trup. Disa moshatarë të tij konstatohen shpesh rrugëve nga postbllloqet herë më shkopin bejsbollit, thika, pistoleta, doreza grushti.

Në një rast njëri prej tyre u justifikua para gjyqtarit se e mbante shkopin e bejsbollit mbasi ishte pjesë e një skuadre. Ndryshe nga 16-vjeçari dhe shokët e tij, njëri me prindër që zotërojnë një furrë buke, tjetri i përkëdhelur nga gjyshërit, ndërsa Aureljo, djali i vetëm është njëfarësoj supi për ekonominë e familjes, dhe familja supi i tij. Ka nisur të mbështesë punën e të atit si elektrikist, pak mbasi rrumbullakosi 18 vjeç dhe ka kuptuar me shumë mundësi diferencat.

Ka fatin e keq që mbasi të sulmohet, fryma do ta lërë aty në atë rreth-rrotullim të mallkuar.



Ndryshe nga dy bashkëmoshatarë të tjerë që u sulmuan barbarisht me thika pak kohë më parë, vetëm e vetëm pse njëri ndër ta kishte krijuar raport me ish-partneren e njërit prej agresorëve.

Në të vërtetë Kodi i Drejtësisë për të Mitur, duke synuar të mos i përballë fëmijët në konflikt me ligjin me sistemin penitenciar, policët, prokurorët, synon të përqaset miqësisht me ta. Pra në formë edukuese, të bëjë atë që familja, shkolla dhe shoqëria dështuan ta bëjë.

Kemi qindra fëmijë që po përfitojnë nga kjo, dhe këta fëmijë as që e kuptojnë se kanë kryer një krim, kundërvajtje apo kanë shkelur ligjin.

Për të folur me shifra, për vitin 2023 janë evindentuar 2600 fëmijë si autorë ngjarjesh kriminale. Fare pak prej tyre janë arrestuar, mbasi ndaj tyre aplikohet instituti i shmangies, që do ishte perfekt nëse do të kryhej i mbikëqyrur, me platforma shkollore apo shkollim i detyruar, dhe masa të tjera kufizuese-edukuese. 1449 të mitur janë dëmtuar gjatë 2023, prej tyre pesë fëmijë janë vvarë, katër janë tentuar të vriten, 46 janë kanosur, 24 fëmijë janë plagosur rëndë, 122 plagosur lehtë me dashje, 139 dëmtime me dashje, 13 të mitur janë vjedhur me dhunë, 514 janë dëmtuar në aksidente si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit, 85 janë keqtrajtuar, 33 janë braktisur nga prindërit, 72 janë dëmtuar nga krimet seksuale.

Dhjetëra fëmijë të tjerë që ndikohen nga jeta online dhe nga modele pa model, si ai i 16-vjeçarit me tre shokë që janë arrestuar, por me gjasë për shkak të moshës ata dalin për punë orësh.

Në familje, në shkollë, në masmedia. Duhet larguar trendi i pakuptueshëm "bad boy", "I pronarit". Po ushqejmë instinktet e gabuara, rritjen para kohe, konkurrencën e pamëshirshme. Më shumë se sa çështje e zbatimit të ligjit, është çështje e edukimit, e parandalimit.

Nuk them se adoleshentë duhet të mbahen për dore

Këtë ata nuk e pranojnë, ndihen të fyer, por gjithsesi, ata duhen orientuar, duhen ndihmuar të kapërcejnë gjendjen stresuese dhe të rënduar psikologjike. Ata duhen shkundur, duhen vënë në lëvizje, duhen hedhur në veprim. Në shkollë është vendi ku duhet të edukohen ndjenja dhe të nxiten ëndrra të bukura, është vend ku hedh shtat personaliteti i adoleshentit, ku ai orientohet

drejt së bukurës dhe së mirës, së drejtës dhe progresives.

Shkolla ka rolin e saj të padiskutueshëm dhe parësor në ndryshimin e gjendjeve dhe përsosjen e realitetit ku jetojmë. Është forca e arsimit dhe e kulturës që shpërndan mjegullën dhe errësirën, prapambetjen dhe injorancën, që i kundërvihet së keqes dhe ligësisë, që mbron të drejtat e adoleshentëve nga dhuna dhe arbitrariteti...

Duke u ndodhur përballë vështirësive, duke ngritur nivelin e punës së saj, shkolla duhet të përdorë edhe ajo "armët" e reja të kohës moderne për të qenë e aftë të fitojë mbi sfidat, dukuritë negative, të ndikojë së bashku me shoqërinë dhe shtetin dhe të "ndërhyjë" bashkërisht që t'i shpëtojnë adoleshentët nga e keqja, të vihet në krye të veprimeve të fuqishme humanitare.

Të vihen në lëvizje energjitë krijuese të adoleshentëve

Ato ekzistojnë, janë të fshehura dhe të struktura brenda tyre, ato duhet të zgjohen, të vihen në lëvizje, të trokitet në to: "Hej, djalosh, zgjohu! Mos fli gjumë! Jeta është e bukur, shiko, hap sytë, hidhu edhe ti në vrullet dhe dallgët e jetës, lëviz, përpiqu, mundohu, përlëshu me të keqen, kapërce majën dhe ec përpara, vazhdo ngjitjen, ke maja të tjera përpara për të kaluar. Tek përballimi i këtyre vështirësive, te kapërcimi i tyre qëndron bukuria e jetës. Kështu, aftësitë, talentet e adoleshentëve nuk kalojnë si hije, pa u ndjerë dhe pa u vënë re, pa mundur të tregojnë aftësitë dhe talentin e tyre...

Natyrisht jo paternalizëm, jo diktim i ideve, por nxitje, krijim i një atmosfere dhe kushteve të përshtatshme që adoleshentët të zgjedhin vetë më të mirën, më interesanten dhe më të bukurën për ta dhe të veprojnë. Atyre nuk mund t'u mohohet zhvillimi i natyrshëm i jetës.

Nuk u duhet "vvarë" fëmijëria dhe rinia, ata duhet ta jetojnë jetën natyrshëm, pa sforco e mundim, nuk duhet t'u diktohet se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë s'duhet të bëjnë, por t'u tregohet e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara nëpërmjet veprimeve, ndodhive, debateve, ballafaqimeve... Ata duhen nxitur, duhen hedhur në veprim me forcën e fjalës, të ideve, të mendimit të mençur.

I miri Aurelio u prehsh në paqe mes engjëjsh!

Prindër, edukator, engjëjt na duhen në tokë, le të punojmë me ta krahe tyre, sepse kjo është detyra jonë!

Në të ardhmen nuk do të ketë liderë burra apo gra, do të ketë thjesht liderë

Gratë kanë shërbyer në ushtri në shumë role të ndryshme në juridiksione të ndryshme gjatë historisë. Gratë në shumë vende nuk janë më të përjashtuara nga disa lloje të misioneve luftarake si pilotimi, mekanika dhe oficerët e këmbësorisë. Që nga viti 1914, në ushtritë perëndimore, gratë kanë shërbyer në numër më të madh dhe role më të ndryshme se më parë.

Në vitet 1970, shumica e ushtrive perëndimore filluan t'i lejonin gratë të shërbenin në detyrë aktive në të gjitha degët ushtarake. Në vitin 2006, tetë vende (Kina, Eritrea, Izraeli, Libia, Malajzia, Koreja e Veriut, Peruja dhe Tajvani) rekrutuan gratë në shërbimin ushtarak. Në vitin 2013, Norvegjia u bë vendi i parë i NATO-s që dërgoi gra, si dhe vendi i parë në botë që rekrutoi gratë me të njëjtat kushte formale si burrat. Në vitin 2017, Suedia fqinje ndoqi shembullin dhe në vitin 2018, Holanda iu bashkua këtij formacioni (megjithëse në Holandë nuk ka rekrutim aktiv në kohë paqej).

Që nga viti 2022, vetëm tre vende rekrutuan gra dhe burra me të njëjtat kushte formale: Norvegjia, Suedia dhe Holanda. Disa vende të tjera kanë ligje që lejojnë rekrutimin e grave në forcat e tyre të armatosura, megjithatë me disa dallime të tilla si përjashtimet nga shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit, dhe më shumë.

Lufta e Parë Botërore

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shtetet e Bashkuara ishin në përpjekje të përgjithshme luftarake. Çdo person duhej të kontribuonte në përpjekjet e luftës, megjithatë, kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht se të gjithë duhej të luftonin. Vendi duhej të vazhdonte të financonte trupat e tij dhe të mbështeste luftën financiarisht ndërsa ushtarët po luftonin. Për këtë qëllim, Shtetet e Bashkuara u mbështetën te organizatat për mbështetje. Gratë iu bashkuan organizatave të tilla si Komiteti për Informim Publik për të edukuar njerëzit për luftën. Ky komitet promovoi edhe nacionalizmin. Përveç punës në komisione që kanë të bëjnë me arsimin, gratë kanë punuar në të gjitha llojet e pozitive. Shumë gra u bënë anëtare të YWCA dhe shkuan jashtë shtetit për të ndihmuar ushtarët. Kjo ishte hera e parë në histori që gratë e të gjitha klasave po punonin së bashku për të ndihmuar përpjekjet e luftës.

Gratë e shtresës së lartë themeluan shumë organizata vullnetare të luftës, ndërsa gratë e klasës së mesme dhe të ulët punonin në këto organizata duke punuar si infermiere ose duke plotësuar punët e burrave.

I vetmi komb që vendosi trupa luftarake femra në një numër të konsiderueshëm ishte Rusia.

Që nga fillimi, rekrutet femra ose iu bashkuan ushtrisë të maskuar ose pranoheshin në heshtje nga njësitë e tyre. Më e shquara ishte një kontingjent i kalorësisë së lehtë të vijës së parë në një regjiment kozak të komanduar nga një kolonele femër, Alexandra Kudasheva.

Kolonele Alexandra Kudasheva (1873–1921) ishte komandantja e një regjimenti të kalorësisë së lehtë ruse nga 1915 - 1917, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe gjithashtu gjatë Revolucionit Rus.

Ky regjiment kalorësie mund të ketë qenë regjimenti i parë i integruar gjinor në historinë ruse. Ajo u shqua gjithashtu për bëmat e saj të kalërimit të qëndrueshmërisë.

Të tjerë përfshinin Maria Bochkareva, e cila u dekorua tre herë dhe u gradua në gradën e nënoficerit të lartë, ndërsa 'The New York Times' raportoi se një grup prej dymbëdhjetë nxënësesh nga Moska ishin regjistruar së bashku të maskuar si të rinj. Në vitin 1917, Qeveria e Përkohshme ngriti një numër batalionesh të grave, me komandën e një komisioni oficerësh Maria Bochkareva.

Ata u shpërndanë para fundit të vitit. Në Luftën e mëvonshme Civile Ruse, ata luftuan si për bolshevikët (këmbësorinë) ashtu edhe për Gardën e Bardhë.

Në Serbi, disa gra individuale luajtën role kryesore ushtarake. Mjekja skoceze Elsie Ingles koordinoi një tërheqje prej rreth 8 000 trupash serbe përmes Rumanisë dhe Rusisë revolucionare, deri në Skandinavi dhe më në fund në anije transporti për në Angli.

Milunka Saviq, u regjistrua në ushtrinë serbe në vend të vëllait të saj. Ajo luftoi gjatë gjithë luftës, duke u bërë ndoshta gruaja më e dekoruar në historinë ushtarake.

Në vitin 1918 Loretta Walsh u bë gruaja e parë që u regjistrua si grua. Një ligj i vitit 1948 i bëri gratë pjesë të përhershme të shërbimeve ushtarake.

Në vitin 1976, grupi i parë i grave u pranuan në një akademi ushtarake të SHBA-së.

Përafërsisht 16% e klasës së "West Point" 2013 përbëhej nga gra. Në Luftën Civile Finlandeze të vitit 1918, më shumë se 2000 gra luftuan në Gardën e Kuqe të Grave. Gjatë Luftës Civile Spanjolle, mijëra gra luftuan në njësitë luftarake dhe preparojë



me gjini të përzier, ose si pjesë e milicive.

Disa vende lejojnë ushtarët femra të shërbejnë në pozicione të caktuara të armëve luftarake. Të tjerët i përjashtojnë ato për arsye të ndryshme, duke përfshirë kërkesat fizike dhe politikat e privatësisë.

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja janë vendet ku u arrit niveli më i lartë i pranisë ushtarake të femrave.

Kanadaja është shënuar si veçanërisht progresive në zbatimin e hershëm të praktikave të barazisë gjinore.

Një rritje e thirrjes për mundësi të barabarta, e shoqëruar me rënien e burrave të aftë për punë, të gatshëm për të hyrë në shërbimin ushtarak, nxiti vendet të reformojnë politikat drejt përfshirjes së grave. Me hapjen e shërbimit të nëndetëseve në vitin 2000, gratë tani kishin lirinë për t'u regjistruar në çdo lloj shërbimi ushtarak.

Gratë mbretërore që veshën uniformën ushtarake

Pas vdekjes së Mbretëreshës Elisabet, familja mbretërore e Mbretërisë së Bashkuar festoi marrëdhënien thellësisht personale të mbretëreshës së ndjerë me Forcat e Armatosura, duke përkrahur atë si një nga lidhjet më të jashtëzakonshme me brezin e kohës së luftës.

Mbretëresha ishte vajza, gruaja dhe nëna e oficerit të marinës, natyrisht. Edhe nipërit e saj kanë shërbyer në Forcat e Armatosura. E njëjta gjë vlen edhe për familjet e tjera mbretërore.

Fotoja e parë është ajo e Princeshës Leonor, trashëgimtares së fronit spanjoll, teksa ajo filloi stërvitjen ushtarake para se të trashëgojë fronin nga babai i saj. Por jo vetëm ato, por të gjithë trashëgimtarët e froneve mbretërore, nuk kanë marrë pushtet pa u rreshtuar kraher Forcave të Armatosura të vendeve respektive dhe pa njohur në thelb 'artin ushtarak'.

Princesha Leonor e Spanjës me uniformën ushtarake në ditën e saj të parë në Akademinë e Përgjithshme Ushtarake të Zaragozës



Princesha Elizabeth me kostumin e saj nga Royal Auxiliary, që kishte veshur për të kryer detyrat ushtarake në 1945



Princeshë Diana me një kostum ushtarak në regjimentin Royal Hampshire në qershor 1988

Princesha e Uellsit, Katte Middleton, duke trajtuar viktimat në fushën e betejës gjatë një stërvitjeje me Gardën Irlandeze



Princesha Anne e Mbretërisë së Bashkuar merr shënjestër me një pushkë SA 80

Princesha Victoria e Suedisë me veshje kamufllazhi demonstroi aftësitë e saj luftarake në trajnimin tre-javor në Almnas, Suedi



Gaqo Tanku, ushtaraku model, studiuesi i 'meritokracisë si kriter bazë në administratë'

Profesor Gaqo Tanku është një nga nxënësit e shkollës "Skënderbej" që pati karrierë të suksesshme ushtarake dhe akademike. Gaqo Tanku ka lindur në Çiflik të Urës Vajgurore, rrethi Berat, më 15.02.1954. Në shtator të vitit 1969 filloi studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" dhe i përfundoi në korrik të vitit 1973. Më pas vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, në Specialitetin Zbulim. Në vitin 1977 titullohet oficer aktiv dhe emërohet shef zbulimi Brigade, njëkohësisht dhe komandant i Kompanisë së Zbulimit të Brigadës (efektiv rezervist). Pak vite më vonë, kryen detyrën e komandantit të Batalionit të Zbulimit të Korpusit të Fierit. Me ndryshimin e strukturës në FA (krijimin e Divizioneve), emërohet shef i zbulimit të Divizionit të Peqinit. Në vijim, ndjek studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe me përfundimin e studimeve në këtë akademi, emërohet komandant i Shkollës së Instruksionit të Zbulimit në Tiranë. Pas ndryshimit të sistemeve politike, emërohet komandant toge, kompanie dhe shef i Formimit të Brendshëm në Brigadën Komando, në Zall Herr. Në vitin 1994, së bashku me disa ushtarakë të tjerë emërohen në rajone jashtë Tiranës, konkretisht në Bulqizë në detyrën e instruktorit të Përgatitjes Fizike në Batalionin e Gatshëm në Brigadën e Këmbësorisë në Bulqizë, por që nuk e kreu, pasi u urdhërua të kryente detyra shërbimi si oficer roje në ish-Batalionin e Këmbësorisë në Çerenecin e Sipërm në rajonin e Bulqizës. Me suprimimin e Brigadës së Këmbësorisë në Bulqizë, del në Rezervë. Rikthehet në Forcat e Armatosura në shtator të vitit 1997 në detyrën e specialistit në Sektorin e Arsimimit në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Me pas, në vitet 2002, pas kthimit nga studimet në Universitetin e Manchesterit në Mbretërinë e Bashkuar, emërohet në detyrën e zv. drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Me suprimimin e vendeve ushtarake në këtë drejtori (u kthyen në pozicione civile), emërohet shef i Sektorit të Arsimimit në Drejtorinë e Personelit të Shtabit të Përgjithshëm dhe në vitin 2004, emërohet oficer shtabi për planifikim-programimin në Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak, si koordinator për Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak për Mbrojtjen me SHBA-në dhe Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE). Në vitin 2007 del në rezervë, por punon për një periudhë dy vjeçare si specialist i parë dhe analist në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes. Në shtator të vitit 2009 pranohet si pedagog me kohë të plotë në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Ne fushën e arsimimit, përveç arsimimit në shkollat ushtarake në vendin tonë, ka kryer edhe një sërë studimesh e kualifikimesh jashtë vendit. Kështu, në vitin 2000-2001, ndoqi studimet për "Master of Science in Human Resource Development", Universiteti i Manchesterit, Angli. Në 2006 mbron doktoraturën me temë "Veçori të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Forcat e Armatosura", ku merr titullin "Doktor i Shkencave Ekonomike", teme e mbrojtur në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, ndërsa në mars të vitit 2015 merr titullin e Profesorit të Asociuar. Ka ndjekur shumë trajnime dhe kualifikime, në tetor 1997 ndjek "Reserve Forces and Mobilization Course", Shkolla e NATO-s, SHAPE, Oberamergau, Gjermani, në Kolegjin e Mbrojtjes në Holandë (kurs 3 mujor), kurs për përgatitjen e ushtarakut për në shtabet ndërkombëtare, Seminari për Menaxhimin e Personelit, Upavon, Angli, kursin "Education and its Major Role in Regeneration, an examination of recent developments and practices in the UK", seminar një javor i organizuar nga Këshilli Britanik në Durham, Angli, në Universitetin i Granfield, Angli "Diplomacia e Mbrojtjes", Resource Management Education Programme Course, NATO School, Oberamergau, Gjermani. Profesor Gaqo ka marrë pjesë në projekte me ekipin Amerikan të KUBIC dhe SAIC në kuadrin e zhvillimit të menaxhimit të burimeve njerëzore në FA etj. Gjatë kohës si pedagog në Universitetin "Aleksandër Moisiu", është zgjedhur Kryetar i Këshillit të Administrimit të UAMD-së.

Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e Gaqo Tankut, zë aktiviteti shkencor. Nga viti 2009 që ka filluar punë me kohë të plotë në fakultet, është angazhuar në mënyrë të ndjeshme në konferenca me një seri punimesh të cilat janë vlerësuar të rëndësishme. Ai ka marrë pjesë në 11 (njëmbëdhjetë) konferenca ndërkombëtare, ku nëntë, janë botuar në "Proceeding", të organizuara nga universitete të



ndryshme (mbajtur në Shqipëri, Rumani), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor. Për sa i përket punimeve shkencore të paraqitura në konferenca, boshti i punimeve të tij ka qenë menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, kënaqësia në punë, përsosja e metodave të përzgjedhjes së personelit etj. Punime të tilla të paraqitura në konferenca mund të përmendim: "Meritokracia, i vetmi kriter për të patur një administratë publike profesionale, Krijimi i Qendrave të Vlerësimit, ndihmesë për të rekrutuar stafin e duhur dhe zhvillimin e suksesshëm të karrierës bazuar në meritokraci"; "The Implementation of 'Lessons Learne' Concept in Business Administration (Implementimi i konceptit të nxjerrja e mësimave në fushën e biznesit) etj..

Ka publikuar gjithashtu librin e lëndës së "Sjellje Organizative", lëndë që zhvillohet në nivelin Master Shkencor dhe Master Profesional etj..

Nënkolonel Gaqo Tanku për shkollën që e rriti dhe formoi do të

“NËNKOLONEL
GAQO TANKU PËR
SHKOLLËN QË E RRTI
DHE FORMOI DO TË
SHPREHEJ: MODELI
QË NA DHA SHKOLLA
JONË E DASHUR
“SKËNDERBEJ”... NËSE
KEMI MUNDUR TË JEMI
KËTA QË JEMI, MË
LEJONI TË PËRMEND
TEORINË E MODELIT, TË
CILËN ÇDO STUDENT I
MENAXHIMIT NË MBARË
BOTËN E STUDION SE
SI DUHET ZBATUAR NË
PRAKTIKË. NE KEMI
PASUR FATIN TË KISHIM
MODELET E GJALLA.

shprehej: Modeli që na dha shkolla jonë e dashur "Skënderbej"... Nëse kemi mundur të jemi këta që jemi, më lejoni të përmend teorinë e modelit, të cilën çdo student i menaxhimit në mbarë botën e studion se si duhet zbatuar në praktikë. Ne kemi pasur fatin të kishim modelet e gjalla. Ndoshta nuk dinim se ekzistonte në atë kohë kjo teori e krijuar nga shkencëtari Alberto Bandura, sipas së cilës, çdo njeri mëson përmes vëzhgimit të sjelljes së të tjerëve. Dhe ata të tjerët që na mësuat, ishin idealistë të vërtetë si ushtarakët që na drejtonin, me në krye komandantin Meço Starja, partizan trim dhe njeri i ndershëm, që na donte sikur të ishim fëmijët e tij. Ndoshta mund të shkruhen libra të tërë për këta njerëz model. Po kështu, nuk do mund të mos them pak fjalë edhe për mësuesen time kujdestare Gjeraqina Spahiun (Osmanlliu), e cila ishte jo thjeshtë mësuese, por ishte dhe motra jonë e madhe. Nuk ishte më shumë se 28 vjeçe e, së bashku me djalin e saj Rezartin e vogël, na mësonte rrugët e Tiranës. Pra edhe një e diel e vetme që ishte pushim, na përkushtohej në atë mënyrë që ndoshta edhe prindërit tanë nuk do ta kishin bërë. Dhe në fund, referuar teorisë së modelit, le të përmend një rast. Personalisht kam qenë zëvendëssekretar i Komitetit të Rinisë të shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej". E, meqë ne ishim vetëm djem, Komiteti i Rinisë i Tiranës, kishte platforma bashkëpunimi me organizatat e rinisë të shkollave të tjera. Rasti e solli që klasa jonë të kishite lidhje me një klasë të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja, godina ku është luajtur filmi 'Lulëkuqet mbi mure'. Për të qenë i singjertë në rrëfimin tim, duhet të them se ne nuk ishim aq të mirë në vallëzim dhe kur shkuam për herë të parë në mbrëmje me vajzat e klasës së gjuhëve të huaja, një nga shokët tanë, pa dashje, i shkeli këmbët. Vajza u nervozua dhe e shtyu paksa me duar. Shoku jonë u skuq, u ul në stolin më të afërt dhe mbuloi fytyrën me duar. Por ishte ajo, motra jonë e madhe, që përkujdesej me mish e me shpirt, e cila u gjend shpejt aty. Ne nuk dëgjua se çfarë i tha ajo vajzës, por pas këtij momenti, vumë re ndryshimin e sjelljes së saj, e cila jo vetëm që i kërkoi ndjesë shokut tonë, por edhe filloi ta mësojë se si të vallëzonte. Ky ishte modeli që fatmirësisht ne patëm. Për arsye etike nuk po përmend emrin e vajzës, pasi sot ajo është figurë e njohur dhe e martuar me një njeri të mrekullueshëm në fushën e sportit, për të cilin ka respekt e tërë Shqipëria...

E vetmja fjalë që mund të them edhe tani pas kaq e kaq vitesh është: Faleminderit e dashur mësuese Gjeraqina!

NATO nis festimet për 75-vjetorin e mbrojtjes kolektive: Kombet me të njëjtin mendim duhet të qëndrojnë së bashku

Përshatja: MIMOZA GOLIKJA

Që nga krijimi i saj, më 4 prill 1949, Aleanca transatlantike është rritur nga 12 anëtarë themelues në 32 vende anëtarë sot, të gjithë duke punuar së bashku për të mbajtur popullin e tyre të sigurt. Një komunitet aleatësh i lidhur së bashku nga vlerat e përbashkëta të demokracisë, lirisë individuale, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, NATO festoi përvjetorin, më 4 prill, në selinë e saj në Bruksel dhe më tej do të vazhdojë në samitin e ardhshëm më 9-11 korrik në Uashington, D.C., ku u nënshkrua traktati themelues i saj.

Në Bruksel, ministrat e Jashtëm u takuan më 3 dhe 4 prill 2024 për të shënuar 75-vjetorin e NATO-s, për diskutimin e çështjeve aktuale dhe për t'u përgatitur për Samitin në Uashington që do të mbahet në korrik të këtij viti.

NATO u themelua mbi një premtime të vetëm, solemn: Një sulm ndaj një aleati është një sulm ndaj të gjithëve. "Nga ai themel, ne kemi ndërtoar Aleancën me të fuqishme dhe me të suksesshme në histori dhe gjatë 75 viteve të fundit, Dera e Hapur e NATO-s ka ndihmuar në përhapjen e demokracisë dhe prosperitetit në të gjithë Evropën", - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përpara takimeve të ministerialit të Jashtëm të NATO-s në Bruksel.

Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti përpjekjet e vazhdueshme të aleatëve për të ofruar dërgesa të mëdha të armëve, municioneve dhe pajisjeve në Ukrainë, duke paralajmëruar se çdo vonesë në mbështetje ka pasoja në fushën e betejës. Ai u bëri thirrje aleatëve që të sigurojnë ndihmë për Ukrainën për një kohë të gjatë. "Ndërsa festojmë arritjet e NATO-s, Evropa sot përballet me luftë të një shkalle që ne menduam se ishte dorëzuar historisë. Ditët e fundit, Kremli ka nisur sulme të reja të mëdha, duke goditur civilët dhe infrastrukturën ukrainase dhe Rusia vazhdon të bëjë presion përgjatë vijës së frontit. Pra, ne duhet të qëndrojmë të vendosur në mbështetje tonë për Ukrainën", - tha Stoltenberg. "E mirëpres që aleatët vazhdojnë të bëjnë dërgesa të mëdha të armëve, municioneve dhe pajisjeve, por Ukraina ka nevoja urgjente", - tha ai, "Çdo vonesë në ofrimin e mbështetjes ka pasoja në fushën e betejës ndërsa flasim. Pra, ne duhet të zhvendosim dinamikën e mbështetjes sonë. Ne duhet të sigurojmë ndihmë të besueshme dhe të parashikueshme të sigurisë për Ukrainën për një kohë të gjatë. Kështu që ne të mbështetemi më pak në kontributet vullnetare dhe më shumë në angazhimet e NATO-s. Më pak për ofertat afatshkurtra dhe më shumë për zotimet shumëvjeçare", - theksoi ai.

Ministrat diskutuan se si NATO mund të marrë më shumë përgjegjësi për koordinimin e pajisjeve ushtarake dhe trajnimit për Ukrainën, duke e ankoruar këtë brenda një kuadri të fortë të NATO-s. Ata diskutuan gjithashtu një angazhim financiar shumëvjeçar për të mbështetur mbështetjen aleate dhe ky ministerial krijoi terrenin për arritjen e konsensusit mbi këto çështje ndërsa NATO përgatitet për Samitin e Uashingtonit. Aleatët e NATO-s ofrojnë 99 për qind të të gjithë mbështetjes ushtarake për Ukrainën. Pra, bërja e më shumë nën NATO-n do t'i bënte përpjekjet e Aleancës më efektive dhe më efektive. Moska duhet të kuptojë se ajo nuk mund t'i arrijë qëllimet e saj në fushën e betejës. Ministrat diskutuan gjithashtu sfidat e sigurisë në rajonin jugor të Aleancës, duke përfshirë kërcënimin e qëndrueshëm të terrorizmit.

Në ditën e dytë, më 4 prill, u mbajt një takim i Këshillit NATO-Ukrainë. Ku me ministrin Kuleba, aleatët trajtuan situatën aktuale dhe nevojat e Ukrainës si tani ashtu edhe për të ardhmen. Aleanca po e transformon paketën gjithëpërfshirëse të ndihmës së NATO-s në një program shumëvjeçar ndihme dhe po ndihmon Ukrainën t'i afrohet NATO-s, standardeve të NATO-s për gjithçka, nga prokurimi tek logjistika. NATO po mbështet përpjekjet reformuese të Ukrainës për ta sjellë Ukrainën gjithnjë e më afër Aleancës. "Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s. Është çështje kur, jo nëse".

Gjithashtu në ditën e dytë, ministrat e NATO-s u takuan me partnerët e tyre në Indo-Paqësor dhe Bashkimin Evropian, ku diskutuan mbi rritjen e bashkëpunimit praktik, si dhe implikimet globale të luftës së Rusisë kundër Ukrainës.

NATO, një rol më të madh në koordinimin e ndihmës për Ukrainën

Në nisje të dy ditëve takime për të shënuar 75-vjetorin e NATO-s dhe për t'u përgatitur për Samitin e Uashingtonit në korrik, ministeriali i Jashtëm i NATO-s u mbledh në Bruksel që më 3 prill 2024. Ky ishte gjithashtu takimi i parë i ministrave të Jashtëm të NATO-s me Suedinë, që merre pjesë si anëtare e plotë.

"Ukrainasve nuk po u mbaron guximi, por po u mbaron municioni", - tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, pas takimit. Ai shtoi se në takimin e tyre ata kishin diskutuar se NATO do ta vendosë mbështetjen e saj në një bazë më të fortë dhe më të qëndrueshme për të ardhmen. "Të gjithë aleatët bien dakord për nevojën për të mbështetur Ukrainën në këtë moment kritik. Ekziston një unitet qëllimi, - tha ai, - aleatët ranë dakord të ecin përpara me planifikimin për një rol më të madh të NATO-s në koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë dhe detajet do të marrin formë në javët në vijim, ku Ukraina mund të mbështetet në mbështetjen e NATO-s tani, dhe për një kohë të gjatë".



"Sapo kemi përfunduar një takim të ministrave të Jashtëm të NATO-s, e para me Suedinë si anëtare e plotë e Aleancës", - informoi në konferencën për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s pas takimeve të ditës së parë të ministerialit të Jashtëm të NATO-s në Bruksel. "Duke filluar nga Ukraina, ky është një moment kritik. Populli i Ukrainës vazhdon të mbrojë vendin e tij me aftësi dhe guxim. Ukrainasit kanë treguar, herë pas here, se janë të aftë. Ukraina ka rimarrë gjysmën e territorit që Rusia ka pushtuar fillimisht. Në Detin e Zi, Ukraina ka shtyrë flotën ruse, duke mundësuar vazhdimin e eksportit të grurit në tregjet botërore. Ukrainasve nuk po u mbaron guximi, po u mbaron municioni", - tha Stoltenberg. "Ne duhet të rritemi tani për të siguruar që mbështetja jonë është ndërtoar për të qëndruar. Pra, në takimin tonë sot, ne diskutuam se si ta vendosim mbështetjen tonë në një bazë më të fortë dhe më të qëndrueshme për të ardhmen. Të gjithë aleatët bien dakord për nevojën për të mbështetur Ukrainën në këtë moment kritik. Ekziston një unitet qëllimi", - tha ai.

Aleatët ranë dakord të ecin përpara me planifikimin për një rol më të madh të NATO-s në koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë. "Detajet do të marrin formë në javët në vijim. Por mos bëni gabim. Ukraina mund të mbështetet në mbështetjen e NATO-s tani, dhe për një kohë të gjatë", - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Ministrat trajtuan gjithashtu sfidat e sigurisë në fqinjësinë jugore të NATO-s, përfshirë kërcënimin e qëndrueshëm të terrorizmit. Tëtorin e kaluar, Sekretari i Përgjithshëm ka emëruar një grup të pavarur ekspertësh për të rishikuar qasjen e NATO-s ndaj fqinjëve të saj jugorë. Ministrat diskutuan në takim gjetjet e Grupit, ndërsa krejtë e shteteve dhe qeverive do të shqyrtojnë propozimet konkrete për këtë në Samitin në Uashington.

Shtetet e Bashkuara të vazhdojnë të jenë një komb udhëheqës në mbështetjen e Ukrainës

Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti Sekretarin e Shtetit të SHBA-ve, Antony Blinken, në selinë e NATO-s, më 3 prill 2024, i cili mbërriti në Bruksel për fillimin e takimi dyditor të ministerialit të Jashtëm. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Blinken për udhëheqjen e tij dhe angazhimin e Shteteve të Bashkuara ndaj NATO-s, si dhe mbështetjen jetike të SHBA-së për Ukrainën. Stoltenberg në deklaratën e përbashkët vuri në dukje se ministrat do të trajtojnë disa çështje, përfshirë rëndësinë e punës me partnerët Indo-Paqësor; shpenzimet e mbrojtjes; dhe përgatitjet për Samitin e Uashingtonit në korrik.

"Ne kemi filluar tashmë takimin tonë të ministrave të Jashtëm dhe kemi trajtuar se si të forcojmë mbështetjen tonë për Ukrainën, për të krijuar një kornizë edhe më të fuqishme për mbështetjen tonë. Dhe unë ju falënderoj për angazhimin tuaj të fortë, angazhimin tuaj personal, angazhimin e Presidentit Biden, për të siguruar që Shtetet e Bashkuara të vazhdojnë të jenë një komb udhëheqës në mbështetjen e Ukrainës", - tha Stoltenberg.

Ndarja e barrës është gjithmonë në krye të agjendës së NATO-s. Kur NATO bëri zotimin për të investuar 2% të PBB-së në mbrojtje, në vitin 2014, vetëm tre aleatë e arritën këtë objektiv. "Sot, dy të tretat e aleatëve të NATO-s po shpenzojnë 2% të PBB-së për mbrojtjen, që është përparim i rëndësishëm. Por sigurisht, ne duam

më shumë aleatë, duam që të gjithë aleatët të jenë në 2%, dhe 2% është minimumi. Pra, ky është një mesazh që unë dhe ne të gjithë e përcjellim me shumë forcë ndërsa përgatitemi për Samitin e ardhshëm të Uashingtonit", - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Lidhur me partnerët e NATO-s në Azi Paqësor, Jens Stoltenberg vuri në dukje se lufta në Ukrainë tregon se sa e ndërthurur është siguria e Evropës me sigurinë e Azisë dhe Paqësorit. "Koreja e Veriut, Kina, Irani po mbështetin agresionin luftarak të Rusisë në mënyra të ndryshme. Pra, kjo tregon se siguria nuk është rajonale, siguria është vërtet globale. Prandaj, është e rëndësishme të punojmë së bashku me partnerët tanë të Azisë Paqësorit", - tha ai duke falënderuar për udhëheqjen e fortë të SHBA-së në këtë çështje.

Duke vazhduar me festimet e 75-vjetorit të NATO-s, në datën 3 prill në mbrëmje pjesëmarrësit e ministerialit u takuan në sallën "Truman". 75-vjetorin e saj, NATO do ta shënojë gjithashtu edhe në Samitin e NATO-s në Uashington në korrik. "Do të jetë një samit i mrekullueshëm për të festuar Aleancën, por gjithashtu për të siguruar që ne të vazhdojmë të përshtatemi dhe të sigurojmë që NATO të vazhdojë të jetë Aleanca më e suksesshme në histori", - Sekretari i Përgjithshëm.

Bashkëpunim praktik me partnerët në Azi-Paqësor

Në ditën e dytë të ministerialit Sekretari i Përgjithshëm kryesoi takimin e ministrave të Jashtëm me partnerët në Indo-Paqësor, Japoninë, Republikën e Koresë, Australinë dhe Zelandën e Re, së bashku me Bashkimin Evropian. Në takim u diskutua se si të përmirësohet bashkëpunimi praktik, si dhe implikimet globale të luftës kundër Ukrainës. "Rusia po merr mbështetje për luftën e saj të agresionit nga Kina, Koreja e Veriut dhe Irani. Ndërsa fuqitë autoritare janë gjithnjë e më të lidhura, është e rëndësishme që kombet me të njëjtin mendim në mbarë botën të qëndrojnë së bashku. Për të mbrojtur një rend global të sunduar nga ligji, jo me forcë", - tha ai.

Ndërsa shënohet 75-vjetori i NATO-s, Aleanca përballet me një botë më të rrezikshme, lidhja midis Evropës dhe Amerikës së Veriut nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme se sa sot. "Ndërsa përgatitemi për një Samit historik në Uashington, NATO do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën. Ne do të vazhdojmë të forcojmë Aleancën tonë dhe do të vazhdojmë të punojmë me partnerët tanë në mbarë globin për paqe dhe siguri", - tha Stoltenberg.

"Ne e dimë se siguria jonë nuk është rajonale, ajo është globale. Lufta në Ukrainë e ilustron këtë qartë. Miqtë e Rusisë në Azi janë jetik për vazhdimin e luftës së saj të agresionit. Kina po mbështet ekonominë e luftës së Rusisë. Në këmbim, Moska po i hipotekon të ardhmen e saj Pekinit. Koreja e Veriut dhe Irani po ofrojnë furnizime të konsiderueshme me armë dhe municione. Në këmbim, Pheniani dhe Teherani po marrin teknologji dhe furnizime ruse që i ndihmojnë ata të avancojnë aftësitë e tyre raketore dhe bërthamore. Kjo ka pasoja të sigurisë rajonale dhe globale", - theksoi shefi i NATO-s. "Pra, kombet me të njëjtin mendim anëtarë botës duhet të qëndrojnë së bashku. Për të mbrojtur një rend global të sunduar nga ligji, jo me forcë". Ministrat diskutuan se si të punojnë së bashku drejt këtij qëllimi. NATO gjithashtu ka shumë për të fituar nga bashkëpunimi praktik, duke përfshirë teknologjinë, kërcënimet kibernetike dhe hibride si dhe mbështetje për Ukrainën. E gjithë kjo ka rëndësi për sigurinë evropiane dhe për sigurinë Indo-Paqësorit. Kundërshtimi i kërcënimeve globale në rritje kërkon shpenzime të qëndrueshme. Stoltenberg tha se: "një numër rekord i aleatëve do të përmbushë objektivat e NATO-s prej 2 për qind të shpenzimeve të PBB-së këtë vit. Mezi pres përparim të mëtejshëm", - tha ai.

Në takimin ministror, u diskutua gjithashtu se si të trajtohet paqëndrueshmëria në rajonin jugor, përfshirë kërcënimin e vazhdueshëm të terrorizmit. Gjithashtu u ra dakord për një politikë të re për gratë, paqen dhe sigurinë. "Sepse shoqëritë tona janë më të forta dhe më të sigurta kur ne marrim kontributin e të gjithë njerëzve tanë", - tha Shefi i NATO-s.

Në ditën e dytë, më 4 prill u mbajt gjithashtu takimi i Këshillit NATO-Ukrainë. Ku me ministrin Kuleba, aleatët trajtuan situatën aktuale dhe nevojat e Ukrainës si tani ashtu edhe për të ardhmen. Aleanca po e transformon paketën gjithëpërfshirëse të ndihmës së NATO-s në një program shumëvjeçar ndihme dhe po ndihmon Ukrainën t'i afrohet NATO-s, standardeve të NATO-s për gjithçka, nga prokurimi tek logjistika. NATO po mbështet përpjekjet reformuese të Ukrainës për ta sjellë Ukrainën gjithnjë e më afër Aleancës.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Qestorati, fshati i mësuesit të mësuesve

Qestorati është një fshat në rrethin e Gjirokastrës, në shpatin perëndimor të malit të Lunxhërisë. Përmendet në burimet e shkruara që në shek. XV. Fshati ka patur shkollë të mesme Bujqësore bashkë me konvikt. Këtu vijon historia e mësuesit të popullit Koto Hoxhi, “mësuesi i mësuesve” dhe “Nderi i Kombit”. Në Qestorat kanë mësuar Petro Nini Luarasi, Pandeli Sotiri dhe shumë nxënës që u bënë mësues dhe pishtarë të përhapjes së gjuhës shqipe në errësirën e perandorisë turke. Koto Hoxhi, figura më e ndritur e Qestoratit e Lunxhërisë e një nga figurat më të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ishte dhe mbeti një nga yjet më të mëdhenj, që ndriçoi për mëmëdhenë në shek. XIX dhe deri më sot. Koto Hoxhi ishte bashkëfshatar e gati moshatar me Kristaq Zografin, ishte shok e mik dhe me bashkëfshatarin Koto Dudin. Të tre këta qestoriatë të dëgjuar, për shumë vite jetuan në Stamboll. Koto Hoxhi ishte ndriçimtari dhe ishte në kryesinë e “Shoqërisë së të shtypurit të shkronjave shqip”, themeluar në Stamboll, më 1879, por dhe flakadani ndër themeluesit e bashkëpunëtorit të revistës “Drita”, në 1884. Pishtari Koto Hoxhi u shqua mbi gjithë rilindësit e tjerë, ashtu si vëllai i tij i idealit, Abdyl Frashëri, ishte përpjekja dhe veprimtaria e tij e palodhur kudo, në atdhe e për atdhe. Koto Hoxhi ishte i thjeshti, i ndershmi, i dituri, i urti, i drejti, humanisti e aktivisti, i pamposhturi, i përkushtuari, i përbetuari, i kudondodhuri i palodhuri, i papërtuari, shpirt-behari e guximmadhi, pasi ai mbolli farë që të lulëzojë. Ai ishte në Qestorat për të punuar e luftuar për gjuhën shqipe, në Gjirokastrë, duke u përpjekur për të hapur shkollën shqipe dhe arriti ta hapte për pak kohë, në Janinë, në Lunxhëri, në fshatrat e Bregut të Labërisë, në Stamboll dhe në Rumani e Bullgari, duke u takuar e biseduar me atdhetarë për mëmëdhenë.

Qestorati, si dhe krahina, shkëlqimin më të madh e patën në shek. XIX. Ndikim të dukshëm, kanë investimi i kurbetlinjve. Shumë kalldrëme, meremetime dhe ndërtime janë bërë në këtë periudhë. Në Qestorat u habit dhe u frymëzua anglezi Lordi Bajron për kulturën dhe traditat e lashta të shqiptarëve. Qestorati ishte skena e parë e teatrit shqiptar me pjesën teatrale “Dasma lunxhote”.

Burra dhe gra të dëgjuar të shek. XIX nga familjet e moçme të Qestoratit ishin: Koto Hoxhi dhe Vasillo Hoxhi me djemtë e tyre Niko, Anastas dhe Janko; Kristaq Zografi dhe Dhomeniqi Zografi dhe djemtë Jorgo dhe Solomon; Koto Dudi dhe Kaçua Dudi me djemtë Kito, Sevo, Anastas, Petro, Nik dhe Gjik; Jorgo Vangjel Zografi me djemtë Viktor dhe Lefter; Thanas Vangjel Zografi me djalin Mihal, si dhe Mitro Papavasili, Lame Leku, Lame Nasti, Mako Doko, Leko Çipi, Anastas Floku dhe të tjerë.

Burra të Qestoratit ishin dhe Anastas Rumbi, Kito Kostlili, Koto Koçi, Nik Mitrokosta, Naço Çipi, Nik Çuçi, Noto Qendri, Lame Papavasili, Petro Floku, Petro Papavasili, Petro Stavri, Nik Stavri, Sevo Foti, Sevo Doku, Thanas Kondili, etj.

Qestorati në Luftën e Dytë Botërore

Në Luftën e Dytë Botërore, Qestorati, si dhe gjithë Lunxhëria, u bë disa herë fushëbeteja midis forcave partizane dhe pushtuesve. Popullsia dhe djallëria qestoriote, me ndjenja të thella atdhetare, morën pjesë aktive për çlirimin e vendit. Fshati u kthye në arenë të luftimeve. Fillimisht në prill 1939 territori i Lunxhërisë u pushtua nga forcat e ushtrisë fashiste italiane. Në këtë rajon u kryen luftime të përgjakshme, që nisën në tetor të vitit 1940 mes forcave të ushtrisë italiane dhe greke. Fronti i luftimeve dhe zotërimi i qytetit prej tyre u këmbye disa herë. Banorët e Qestoratit dhe të Lunxhërisë u përfshinë qysh në muajt e parë në rezistencën antifashiste dhe u lidhën ngushtë me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shumë djem dhe vajza mbushën radhët e formacioneve luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të forcave nacionaliste. Formacionet e para luftarake të organizuara dhe udhëhequra nga Partia Komuniste Shqiptare, të cilat nisën veprime ushtarake kundër pushtuesve fashistë italianë dhe gjermanë ishin çetat partizane e “Rinisë” dhe “Koto Hoxhi” etj. Ndërkohë që këto çeta me zgjerimin e radhëve u organizuan në batalionin “Misto Mame” dhe më pas në brigadat sulmuese. Këshilli nacionalçlirimtar u formua në tetor 1942. Në Qestorat, më 7-8 shkurt 1944, zhvilluan luftime forcat e BrVIS me forcat gjermano-balliste, e cila ishte një nga betejat më të ashpra midis forcave partizane dhe gjermano-balliste e që arriti trup me trup. Në histori ka hyrë si “Lufta e Qestoratit”, ku atë ditë forcat gjermano-balliste dogjën Qestoratin, ku shumë saraqe u bënë hi dhe njerëzit ngelën në qiell të hapur. Nga Qestorati dolën partizanë

Misto Çipi, partizani nga Qestorati



dhe luftëtarë të lirisë: Misto Naço Çipi, zëvendëskomandant i batalionit “Misto Mame”, Sofo Lame Papavasili, Ndriko Pandeli Kushta, Panajot Pilo Leku (dëshmor), Stavro Petro Floku, Telo Sevo Mitrokosta, Leko Qiro Çipi, Leko Pilo Leku, Llambo Pilo Leku, Mako Aleks Maku, Noto Koço Duka, Petro Mihal Zografi, Zoto Gole Qirjazi, Mihal Gole Qirjazi, etj.

Përkrahja e Lëvizjes Antifashiste prej tij, bëri që nga fshati Qestorat të rreshtohen 14 partizanë nga të cilët dy dhanë jetën për liri Vangjel Jorgji Milingu dhe Panajot Pilo Leku dhe janë “Dëshmorë të Atdheut”.

U pushkatua se kundërshtoi idenë e luftimit

Misto Naço Çipi lindi në Qestorat, në vitin 1880, në një familje të nderuar e patriotë të Lunxhërisë. Babai i tij, Naço ishte i dëgjuar në krahinë për trimëri dhe miqësi, burrë zakoni, ku në shtëpinë e tij kuvendonin burrat për të ardhmen e vendit. Ishte koha kur Qestorati lulëzonte dhe fshati kishte pamjen e një qyteti që rrezatonte kulturë dhe dije. Në këtë mjedis qestoriot u rrit, mësoi dhe u burrërua dhe trimi Misto Çipi. Në jetë ai eci në rrugën e babait të tij, Naço, që nderohej, respektohej dhe i merrej mendim për probleme të fshatit dhe të krahinës. Rrugën atdhetare të babait e vazhdoi dhe Misto, i cili në të gjitha dallgët e përplasjeve prej atdhetari të kohës ishte në krahun e duhur të historisë.

Misto Çipi falë dhe miqësisë me burra patriotë si Lipe Bogai, ishte i pari që deklaroi hapur qëndrimin e tij antifashist dhe u bë pjesëmarrës aktiv në LANÇ. Kontributi i tij ishte i gjithanshëm. Ishte fisnik dhe me autoritet, fjala e tij dëgjohej e respektohej nga qestoriotët. Kështu Familja Çipi u lidh ngushtë me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke dhënë një kontribut të çmuar për çlirimin e vendit. Andon Çipi, kuadër i lartë në organet shtetërore të qeverisë Mbretërore, iu kundërvu fashizmit dhe provoi vuajtjet e torturave të internimit në Porto Romano.

Kështu patrioti i moshuar Lipe Bogai nga Saraqinishta dhe Misto Çipi nga Qestorati, dhe të gjithë lunxhiotët, duke patur me vete dhe ÇP të “Rinisë” të inaguruar në Stegopol më 20 qershor 1943, bënë përpjekje të shumta për krijimin e një batalioni partizan në zonën e Lunxhërisë. Merita e veçantë e tij ishte shtimi i radhëve me partizanë qestoriotë. Edhe pse në moshë të thyer Misto u caktua zëvendëskomandant i batalionit partizan “Misto Mame”. Kjo bëri që gjithë rrethi familjar Çipi të lidhej edhe më ngushtë me luftën. Ngjarja e kundërshtimit të idesë së vendimit për vendosjen e luftëtarëve nga Lunxhëria në vijë të parë në Cepo për mbrojtjen e saj dhe në vijë të dytë partizanët e zonës, bëri që

të merrej një vendim ekstrem ndaj tij, pushkatimi. Komandanti i BP “Misto Mame”, kur mori vesh ndodhinë, u step dhe mendoi gjatë deri në dorëheqje si i moshuar... Pas çlirimit u rehabilitua dhe krahina e konsideruan dëshmor.

Shkruar për Misto Çipin në libra...

Veteranët Sofo Papavasili, Thimjo Muçi, Luto Haxhi, Piro Koçi, në librin “Batalioni Misto Mame” të botuar në Tiranë në vitin 2000 kanë shkruar: Misto Çipi, zëvendëskomandant, rridhte nga një fis i dëgjuar lunxhiot, me rreth familjar, që kishte autoritet të madh në krahinë. Duke qenë pjesëmarrës aktiv në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai dha një kontribut të çmuar kundër pushtuesve. Misto qe një burrë fisnik e me autoritet. Fjala e tij zinte vend në popullin lunxhiot, ndaj ai përpiqej ta tërhiqte atë në veprimtarinë antifashiste. Me fillimin e luftës, megjithëse në moshë të thyer, u hodh në rreshtat partizane dhe me formimin e batalionit “Misto Mame” u emërua zëvendëskomandant i tij.

Vetë Mistoja luajti një rol të veçantë në mobilizimin e lunxhiotëve në rreshtat partizane. Ai ka një meritë të posaçme për shtimin e radhëve të partizanëve në batalionin “Misto Mame”, bashkë me Lipe Boganë. Në disa rrethana të dyshimta e të sajura në prapaskena, ai u mënjanua në kulmin e aktivitetit të tij luftarak. Pas çlirimit u rehabilitua, dhe partizanët e batalionit, si dhe krahina e konsideruan dëshmor të nderuar.

Tase Çorri në librin “Në emër të lirisë”, botuar në Tiranë, në vitin 2008, ka shkruar: “Në ato çaste të rënda patëm edhe viktima nga nxitimi e mos thellimi i veprimeve siç ishte Misto Çipi, i cili për një gabim shprehje apo takti luftarak në Cepo u gjykua e u pushkatua. E them me bindje se ai nuk mund të quhet armik. Pavarësisht të metave, ato nuk duhet të shkonin deri në ekzekutim fizik ndaj një partizani që kishte rrëmbyer armët vullnetarisht kundër armikut. Masa ekstreme që merrej ndaj tij s’duhet të kalonte më tepër se shkarkimin nga posti i zëvendëskomandantit në partizan të thjeshtë. Ai ndëshkim ndaj Mistos më ka ngelur në mendje dhe më ther në shpirt njëlloj si të tri plagët që kam në trup nga nazistët në çlirimin e Tiranës...”.

Edhe pse u kërkua falje pas çlirimit për pushkatimin e zëvendëskomandantit të batalionit partizan “Misto Mame”, Misto Çipi, nuk u bë kurrë një kërkesë për t’u shpallur Dëshmor i Atdheut. Ai kujtohet në përvjetorët e festës së batalionit dhe emri i tij është radhitur në listën e partizanëve të batalionit, por në listën e gjatë të dëshmorëve të batalionit, emri i tij ende mungon...

Çmimi Evropian për Gratë Inovatore

Komisioni Evropian shpalli fituesit dhe nënkampionet e edicionit të 10-të të Çmimit Evropian për Gratë Novatore. Gratë po frymëzojnë brezat e ardhshëm të novatorëve dhe theksojnë rëndësinë e diversitetit dhe barazisë gjinore në drejtimin e agjendës evropiane të inovacionit përpara.

Iliana Ivanova, Komisionerja për Inovacion, Kërkim, Kulturë, Arsim dhe Rininë, tha: “Ky edicion i Çmimit Evropian për Gratë Inovatore shënon dhjetë vjet të festimit të grave që po udhëheqin rrugën në inovacion dhe sipërmarrje në të gjithë Evropën. Urimet e mia më të ngrohta për të gjithë fituesit dhe nënkampionët. Idetë e tyre novatore, pasioni dhe vendosmëria na frymëzojnë të gjithëve dhe na kujtojnë rëndësinë e nxitjes së ekuilibrit gjinor në peizazhin e inovacionit të Evropës”.

Edicioni i 10-të i çmimit tregon arritjet e jashtëzakonshme të fituesve dhe të dytave në tre kategori:

1) Gratë Novatore, për të gjitha gratë themeluese dhe bashkëthemeluese në të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së dhe Vendet e Asociuara në Horizon Europe:

Fituese: Rana Sanyal (Turkiye), Zyrtare Kryesuese Shkencore dhe Bashkëthemeluese e RS Research, e cila zhvillon nanomilaçe të zgjuara për kimioterapinë e synuar.

Nënkampionët: Natalia Tomiyama (Gjermani), Drejtoreshë Menaxhuese dhe Bashkëthemeluese e NÜWIEL, e cila zhvillon e-rimorkio që mund të përputhen me lëvizjen e këmbësorit ose motoçiklistit që e tërheq atë.

Elena García Armada (Spanjë), CEO dhe bashkëthemeluese e Marsi Bionics, e cila zhvillon ekzoskelete pediatrike dhe gjunjë robotikë.

2) Rising Innovators, për vajzat e reja premtuese novatore nën moshën 35 vjeç:

Fitues: María González Manso (Spanjë), Kryeshefe Ekzekutive dhe Bashkëthemeluese e Tucuvi, e cila automatizon konsultimet telefonike pasuese me inteligjencën artificiale empatike.

Nënkampionët: Sara Correyero Plaza (Spanjë), CEO dhe Bashkëthemeluese e IENAI SPACE, e cila zhvillon module elektrike shtytëse për nanosatelitët së bashku me optimizimin e misionit.

Bàrbara Oliveira (Irlandë), CTO dhe bashkëthemeluese e Luminate Medical, teknologjia e së cilës ndihmon në parandalimin e efekteve anësore të trajtimit të kancerit.

Eva Sadoun (Francë), CEO dhe Bashkëthemeluese e Lita.co, gjë që e bën më të lehtë investimin në ndërmarrjet sociale.

3) Udhëheqja e grave të EIT, për anëtarët e jashtëzakonshëm të Komunitetit të EIT:



Fituese: Yuliia Bialetska (Ukrainë), Kryeshefe Ekzekutive dhe Bashkëthemeluese e S.lab, e cila zhvillon alternativa ndaj ambalazheve plastike me shumë.

Nënkampionët: Deniz Ficicioglu (Gjermani), Drejtor Menaxhues dhe Bashkëthemelues i BettaFish GmbH, e cila zhvillon alternativa të peshkut me bazë alga deti.

Cristina Purtill (Irlandë), CEO e Plio Surgical, e cila zhvilloi një zgjidhje magnetike për rikuperimin e zorrëve pas operacionit.

I menaxhuar së bashku nga Këshilli Evropian i Inovacionit dhe Agjencia Ekzekutive e SME-ve (EISMEA) dhe Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT), Çmimi Evropian për Gratë Novatore nënvizon rolin e paçmuar të grave në nxitjen e ndryshimeve transformuese dhe nxitjen e rritjes së nxitur nga inovacioni në Bashkimi Evropian. Ky vit historik shënon dhjetë vjet të nderimit të grave të jashtëzakonshme që kanë nxitur inovacionin dhe sipërmarrjen në të gjithë Evropën.

Shkencëtarët përdorin inteligjencën artificiale për të stabilizuar për herë të parë shkriren bërthamore

Studiuesit në Universitetin “Princeton” kanë zhvilluar një kontrollues AI që mund të parashikojë paqëndrueshmëritë e plazmës në një reaksion të shkrires bërthamore dhe të rregullojë kushtet e plazmës për t’iu përshtatur reagimit të vazhdueshëm.

Kjo risi mund ta bëjë shkriren bërthamore më të realizueshme dhe të shkallëzueshme se kurrë.

Aktualisht, të gjitha termocentralet bërthamore të prodhuara nga njeriu prodhojnë energji nëpërmjet ndarjes bërthamore, një proces që përfshin ndarjen e atomeve dhe prodhimin e mbetjeve radioaktive afatgjatë.

Dielli dhe yjet në anën tjetër fuqizohen natyrshëm nga shkrija bërthamore, një lloj tjetër reaksioni atomik ku bashkohen dy bërthama në një.

Krahasuar me ndarjen bërthamore, reaksioni i shkrires prodhon më shumë energji, shumë më pak (dhe jetëshkurtër) mbetje radioaktive dhe nuk kërkon uranium.

Shumë shkencëtarë besojnë se shkrija bërthamore mund të shërbejë gjithashtu si burimi më i pastër dhe më i gjelbër i energjisë në Tokë. Në studimin e tyre të ri, studiuesit e Universitetit “Princeton” zbulojnë se si kontrolluesi i ri i AI-së mund t’i ndihmojë njerëzit të arrijnë këtë qëllim.

Sfida me shkriren e qëndrueshme bërthamore

Në dhjetor 2022, për herë të parë, shkencëtarët arritën me sukses prodhimin neto të energjisë nga një reaksion i shkrires bërthamore. Megjithatë, një sasi shumë e vogël energjie (vetëm sa për të zier një kazan) u prodhua gjatë atij reagimi.

Kjo ndodh sepse megjithëse shkencëtarët arritën me sukses shkriren bërthamore, ata nuk e dinin se si mund ta mbanin reagimin për një kohë të gjatë.

Për të arritur një reaksion të qëndrueshëm të shkrires, duhet gjithashtu të mbahet plazma, një gjendje e materies që përbëhet nga gazra jashtëzakonisht të nxehtë dhe elektrone të lirë (në temperatura që arrijnë miliona gradë Celsius). Kjo gjendje plazmatike e jonizuar me energji të lartë është e nevojshme për të lehtësuar shkriren e dy bërthamave në një.

Megjithatë, në temperatura kaq të larta, çdo gjë mund të shkojë keq. Edhe një ndryshim i vogël në plazmë mund të



destabilizojë reagimin. Shkencëtarët kanë provuar më parë kontrollues të paraprogramuar për të ruajtur kushtet e plazmës, por ato mjete dështuan, sipas studiuesve. Deri më tani, nuk kishte asnjë mënyrë për të mbajtur gjurmët e plazmës në kohë reale dhe për ta mbajtur atë të qëndrueshme.

Kontrolluesi i AI-së zgjidh problemin e plazmës

Për të zgjidhur problemin dhe për të parandaluar paqëndrueshmëritë e plazmës, studiuesit krijuan një kontrollues AI që përdor të dhëna nga mjete të shumta diagnostikuese shumë të avancuara që funksionojnë në DIII-D, një strukturë kombëtare

e shkrires në San Diego. “DIII-D është i pajisur me sisteme të diagnostikimit të plazmës në kohë reale me rezolucion të lartë. Këto mjete diagnostikuese lejojnë profilizimin në kohë reale të densitetit të elektroneve, temperaturës së elektroneve, temperaturës së joneve, rrotullimit të joneve, presionit, densitetit të rrymës dhe faktorit të sigurisë”, - theksojnë studiuesit.

AI-ja i përpunon këto të dhëna në kohë reale dhe i lejon studiuesit të parashikojnë se si do të silllet plazma në kushte të ndryshme. Me ndihmën e AI-së, ata mund të parashikojnë çdo paqëndrueshmëri 300 milisekonda përpara se të ndodhë.

Ndërkohë, bazuar në informacionin në kohë reale dhe rezultatet e tyre të propozuara, ata mund të testojnë metoda të ndryshme që mund të përdoren për të kontrolluar dhe stabilizuar plazmën, duke manipuluar kushtet e saj.

Ndërsa 300 ms mund të tingëllojnë si pa kohë për një person normal, autorët e studimit pohojnë se kjo kohëzgjatje do të ishte e mjaftueshme për të bërë ndonjë ndryshim për të siguruar stabilitetin e reagimit. Ata madje testuan kontrolluesin e AI-së për të mbështetur pretendimet e tyre. “Ne demonstrojmë kontrollin e inteligjencës artificiale për të ulur mundësinë e paqëndrueshmërisë së grisjes në DIII-D6, objekti më i madh i shkrires magnetike në Shtetet e Bashkuara”, - thanë studiuesit. “Kontrolluesi ruajti gjasat e krisjes nën një prag të caktuar, edhe në kushte relativisht të pafavorshme të faktorit të ulët të sigurisë dhe çift rrotullues të ulët. Në veçanti, ajo lejoi plazmën të gjurmonte në mënyrë aktive rrugën e qëndrueshme brenda hapësirës operationale që ndryshon nga koha”, - shtuan ata.

Studimi është publikuar në revistën “Nature”.

SHBA teston dronin supersonik me të ardhme hipersonike për të sfiduar Kinën

Venus Aerospace ka raportuar se ka testuar me sukses motorin e saj rrotullues të shpërthimit (RDE) në një dron të vogël mbi Shtetet e Bashkuara. Droni fluturoi me shpejtësi nënsonike për mbi 10 milje (16 km), duke dëshmuar teknologjinë. Motori i ri premton udhëtime hipersonike, duke rivalizuar përpjekjet nga vende të tjera si Kina.

RDE-të ofrojnë efikasitet të lartë termodinamik dhe dizajn kompakt, duke i bërë ato premtuese për sistemet shtytëse dhe energjitike në të ardhmen. Për këtë arsye, kombe të ndryshme po punojnë shumë për t'i zhvilluar ato.

Kina, për shembull, kohët e fundit raportoi se kishte zhvilluar një qe, në teori, mund të arrijë 16 Mach. Japonia raportoi se kishte bërë përparim të mirë me RDE-në e saj në vitin 2021. "Raytheon" po punon gjithashtu me Agjencinë e Projekteve të Kërkimit të Avancuar të Mbrojtjes së SHBA-së (DARPA) për të bërë një i quajtur "Gambit".

Sidoqoftë, RDE-të funksionojnë shumë ndryshe nga motorët konvencionalë, si raketat. Në një motor tipik rakete, shtytësi dhe oksiduesi përzihen dhe ndizen në një dhomë me djegie për të prodhuar një shtëllungë të fuqishme shkarkimi. RDE-të, megjithatë, punojnë duke përdorur një valë shpërthimi që udhëton rreth një kanali rrethor.

"Venus Aerospace" po punon me DARPA

Kjo valë shpërthimi mbahet nga injektimi i karburantit dhe oksiduesi, të cilët prodhojnë një valë goditëse që lëviz nga jashtë me shpejtësi supersonike. Ashtu si Raytheon, Venus Aerospace po bashkëpunon me DARPA për të zhvilluar një pajisje për testimin e teknologjisë hipersonike.

Droni 8 këmbë i gjatë, i cili peshon 300 paund (136 kg), fluturoi në një lartësi prej 3 658 metra me 0,9 Mach. Motori ushqehet nga peroksidi i hidrogjenit, duke e shtyrë motorin e tij monopropellant me shtytje 80%, për të mos kaluar 1 Mach. Motori prodhon rreth 5 338 Njuton shtytje me një unazë zjarri 10,16 cm.

Droni u hodh nga një avion Aero L-29 "Delfin". Ky motor nuk iu nënshtrua shtytjes së plotë gjatë testimit për shkak të kufizimeve të gamës së testimit të papërcaktuar në Shtetet e Bashkuara.

Vendndodhja, shpjegoi "Venus Aerospace", nuk lejonte testimin e fluturimit supersonik.

Pas testit, Venus është e bindur se mund të kombinojë teknologjinë e saj RDE me teknologjinë e frymëmarrjes së ajrit. Kjo përfshin përdorimin e lëvizjes përpara të motorit për të gëlltitur ajrin për djegie, duke rezultuar në një motor me cikël të kombinuar me bazë raketa.

Zhvillimi i suksesshëm i këtij motori do t'i mundësonte Venusit të arrijë performancë të shkëlqyer në një gamë të gjerë lartësish dhe shpejtësish. Ndërsa kjo ide ka qenë kryesisht teorike dhe e studiuar në universitete në vend që të ndiqet për qëllime komerciale, Venusi tani po ndërmerr hapa për ta bërë atë realitet.

RDE-të janë e ardhmja

Testi demonstroi kontrolle të suksesshme të fluturimit, stabilitet, telemetri, lëshim ajror dhe një këmbë të sistemit të fundit të shtytjes dhe operacioneve tokësore të motorit të raketave me shpërthim rrotullues (RDRE).

"Përdorimi i një platforme të lëshuar nga ajri dhe një konfigurimi rakete me krahë na lejon të arrijmë me çmim të lirë dhe shpejt në testin minimal të zbatueshëm të RDRE-së tonë si një motor hipersonik. Ekipi e ekzekutoi atë me profesionalizëm dhe ka një mori të dhënash për të ankoruar dhe modifikuar për fluturimin e ardhshëm", - tha CTO dhe bashkëthemeluesi Andrew Duggleby.

"Kështu i bëni gjërat e vështira: një kafshatë në një kohë. Më pas është fluturimi RDRE, dhe në fund fluturimi hipersonik, duke dëshmuar se RDRE është motori që zhbllokon ekonominë hipersonike", - tha CEO dhe bashkëthemeluesja Sarah Duggleby "Sassie".

Venus tani planifikon të zhvillojë një mjet më të madh 3.7 metra testimi, që duhet të jetë gati për testim deri në vitin 2025. Kjo platformë më e madhe duhet të jetë e aftë për 4 ose 5 Mach. Objektivat afatgjata të Venusit janë të zhvillojë një automjet të madh 9 Mach dhe një aeroplan komercial për pasagjerë të pajisur me RDE 2+ Mach.



RDE-TË FUNKSIONOJNË SHUMË NDRYSHE NGA MOTORËT KONVENCIONALË, SI RAKETAT. NË NJË MOTOR TIPIK RAKETE, SHTYTËSI DHE OKSIDUESI PËRZIHEN DHE NDIZEN NË NJË DHOMË ME DJEGIE PËR TË PRODHUAR NJË SHTËLLUNGË TË FUQISHME SHKARKIMI. RDE-TË, MEGJITHATË, PUNOJNË DUKE PËRDORUR NJË VALË SHPËRTHIMI QË UDHËTON RRETH NJË KANALI RRETHOR.



Shqipëria, vendi i bekuar nga bukuritë natyrore

Parku Kombëtar "Mali i Dajtit"

Parku Kombëtar "Mali i Dajtit" është një nga zonat më të bukura natyrore të Tiranës, i vendosur në Veri-Lindje të Tiranës, i shtrirë në dy qarqe: Tiranë dhe Durrës. I pari park kombëtar që prej datës 16.02.1960. Me VKM nr. 402, datë 21.06.20006, sipërfaqja e Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit zgjerohet duke arritur në 29,216.9 ha, kategoria II e IUCN. Lartësia e Malit të Dajtit është 1,613m, mbi nivelin e detit. Lartësia maksimale e tij është 1,827m, maja e Mecekut, të Shënmërisë.

Mali i Dajtit nuk është vetëm pjesë e peizazhit të qytetit të Tiranës, por ai është mushkëria e këtij ekosistemi të madh urban. Përbën një nga mjediset natyrore më të rëndësishëm në Shqipëri, jo vetëm për vlerat e larta të biodiversitetit dhe të peizazhit që ai mbart, por edhe sepse përbën qendrën më të madhe çlodhëse të vendit tonë për shkak të pozicionit pranë kryeqytetit të vendit. Zonë me vlera peizazhore, kulturore dhe historike e tradicionale. PK Mali i Dajtit ofron mundësi të shkëlqyera për aktivitete sportive e edukuese, përfshirë ecjen në natyrë apo shëtitjet me biçikleta, piknikë etj.

Parku kombëtar i Malit të Dajtit mund të vizitohet nëpërmjet



teleferikut ose duke ndjekur rrugën automobilistike.

Parku Kombëtar i Llogorasë

Parku Kombëtar i Llogorasë gjendet në juglindje të qytetit të Orikumit dhe 37 km larg qytetit të Vlorës. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022 ky park zgjerohet përtej sipërfaqes së ekosistemit natyror "Llogora", shpallur "park kombëtar" (kategoria II), nga 1 010 ha në 1 769.2 ha.

Gjendet afro 40 km në juglindje të qytetit të Vlorës, në kufirin hapësinor midis detit Adriatik dhe Jon. Formohet nga një pellg ujëmbledhës me pyje, kullotë e livadhe dhe vende shkëmbore, tepër të thepisur. Afro gjysma e sipërfaqes ka pjerrësi mbi 30 gradë, me kënddrejtim veriperëndimor, me lartësi nga niveli i detit që varion nga 450-2,018m, maja e Qores. Toka është e murrme pyjore dhe livadhore malore, mbi gëlqeror.

Në këtë park gjenden të gjitha zonat e bimësisë së vendit tonë. Zona e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare, me lartësi 470-600m; Zona e dushkajave, në lartësitë 600-800m; Zona e Ahut, në lartësitë 800-1,300m dhe Zona e kullotave alpine, në lartësitë 1,300-2,000m. Për të mundësuar realizimin e objektivave të ruajtjes së parkut studimet e më vonshme kanë marrë në konsideratë të gjithë rajonin: Llogora, Rreza e Kanalit, Karaburun, Laguna e Orikumit, Lugina e Dukatit

dhe Gjiri i Dukatit.

Parku Kombëtar Detar, Karaburun-Sazan

I vetmi Park Kombëtar Detar, ai i Karaburun-Sazan është një mrekulli e gjallë e natyrës Shqiptare. Ky park konsiderohet si shtëpia e 36 specieve detare me rëndësi ndërkombëtare mes tyre kemi dhe specie të cilat i përkasin listave të llojeve të rrezikuara. Ekosistemi ujor/detar "Karaburun - Sazan", i shpallur "park kombëtar detar" (kategoria II), me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 26.01.2022 zgjerohet nga 12 428 ha në 12 437.7 ha.

Shtrihet në hapësirën detare me gjerësi 1 milje detare, përgjatë Gadishullit të Karaburunit (nga Kepi i Shën Vasilit deri te faqja e Langadhës) dhe rreth Ishullit të Sazanit.

Shpatet e Gadishullit të Karaburunit janë vende tejet të rrëpira në anën perëndimore, me kulme të larta në pjesën qendrore. Bregu Perëndimor i Gadishullit skalitet nga shpella dhe kanione të thella, që rrallëherë përfundojnë me plazhe zalli ose xhepa rëre. Shpatet e tij karakterizohen nga shkëmbinj të lartë vertikale që vazhdojnë nën ujë në thellësi të mëdha. Këta shkëmbinj janë tepër të gërryer dhe mund të vërehen një numër i madh shpellash, kryesisht nënujore, aty ku shpesh rrjedhin burime të ujërave të ëmbla.

Gadishulli i Karaburunit është vendi më i spikatur me cilësi mesdhetare. Karakterizohet nga një nivel shumë i ulët turbullimi të ujit.

Mjedisi medio-litoral karakterizohet nga formacione korologjene ndonjëherë mbi një metër, të përbëra prej algash korologjene, lloj i mbrojtur dhe shumë i veçantë nga pikëpamja gjeo-morfologjike, biologjike dhe turistike, dhe që mund të shfaqet me pamje jashtëzakonisht të mahnitshme.

Ishulli i Sazanit (16km i gjatë dhe 3-5km i gjerë), përballë Vlorës dhe në veri të gadishullit të Karaburunit, ka një formë elipsoide në veri-verijug-juglindje, duke pasur majën kulmore në lartësi 345m, tek Gryka e Djallit. Pjesa perëndimore karakterizohet nga brigje shkëmbore vertikale që janë skalitur nga kanione të thella dhe që zgjerohen nga shpella të shfaqura kryesisht nën-ujë, siç shfaqen tek



Gadishulli i Karaburunit. Kanionet më të rëndësishme janë tek Kepi i Pëllumbave dhe Gryka e Ferrit. Në pjesën lindore, vija bregdetare është më e ulët dhe pjesa jugperëndimore e saj formohet nga shtresa të rrëpira gëlqerore që zhyten në det.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta

Zona më e rëndësishme komplekse e Shqipërisë për sa i përket biodiversitetit. Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta është një zonë e mbrojtur në zonën bregdetare të Shqipërisë, përbëhet nga ekosisteme komplekse, shumë të pasura në biodiversitet dhe burime natyrore. Është shpallur edhe si zonë e mbrojtur natyrore për shpendët e ujit, si ligatinë me rëndësi ndërkombëtare sipas Konventës së Ramsarit, që nga viti 1995. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 26.1.2022 ky park zgjerohet nga 22 230.2 ha në 22 389.08 ha.

Shtrihet si një hark i gjelbër anës detit Adriatik, gjendet rreth 5km larg qytetit të Divjakës dhe afro 70km larg Tiranës.





Ai kufizohet nga lumi Shkumbin në veri, nga kodrat e Divjakës në Lindje, nga kanali i Myzeqesë dhe lumi Seman në jug, dhe laget nga deti Adriatik në perëndim.

Rezervat Natyror “Bredhi i Kardhiqit”

Rezervat Natyror i Menaxhuar, “Bredhi i Kardhiqit”, pjesë e Qarkut Gjirokastrë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 26.1.2022 u miratua ndryshimi i sipërfaqes së ekosistemit natyror “Bredhi i Kardhiqit” nga “rezervë strikte natyrore” (kategoria I e zonave të mbrojtura) në “rezervat natyror i menaxhuar” (kategoria IV e zonave të mbrojtura), me sipërfaqe 1 800 ha në 4 303.6 ha.

Shtrihet në shpatet e Malit të Gjerë, përgjatë luginës që krijon rrjedha e degës së djathtë të Lumit të Kardhiqit, degë e Lumit Drino. E gjithë zona vendoset mbi substrate gëlqerore dhe dallohet për shkak të pasazhit me larmi formash karstesh si dhe një florë të veçantë dhe faunë të pasur.

Ka reliev mjaft të thyer dhe shumë të thepisur, me kontraste të konsiderueshme dhe shtrirje nga 600-1 600m. Janë të shumta format e relievit karstik, prej të cilave dallohet kanioni i Piksit, me gjatësi 100m, thellësi 50-60m e gjerësi 2-3 m, i formuar nga shembja e tavaneve të kalimit të dikurshëm nëntokësor të lumit të Piksit, degë e Lumit të Kardhiqit. Vende-vende kanioni shndërrohet në tunele natyrore, të cilat janë mbetje të gjendjes së dikurshme të tij.

Parku Kombëtar i Butrintit

Parku Kombëtar i Butrintit është një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike të vendit. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 26.1.2022, Parku Kombëtar “Butrint”, ka sipërfaqe 8 622.2 ha. Ndodhet 25 km larg qytetit të Sarandës dhe shtrihet nga brigjet e detit Jon të fushëgropës së Delvinës deri 825m (maja e Milesë).

Larmia e jashtëzakonshme e habitateve natyrore (nga detare dhe ligatinore në perëndim në habitatet malore në lindje) dhe ndërthurja e tyre me site arkeologjike, historike e kulturore të rralla krijon një peizazh magjik të veçantë në Mesdhe. Sipërfaqja tokësore dhe ishujt përbëjnë peizazhe të mrekullueshme detare dhe tokësore, zonën më të rëndësishme në vend, ku ruhen në gjendje natyrore ose gati natyrore, shkurre dhe pylli mesdhetar përherë të blertë, ku mbizotërojnë Ilqja, Rrënja, Vërriu, Vidhi, Frashëri, etj. Në brendësi të parkut gjendet

të tillë si Kalaja mesjetare e Ali Pashë Tepelenës, e sidomos rrënojat arkeologjike të qytetit të Butrintit, me fillesat që në shek. IV p.e.s. Për këtë arsye, pjesa arkeologjike e saj, në Gadishullin e Butrintit, është shpallur pjesë e UNESCO-s, që më 1999, gjë që rrit më tej atraksionin ekoturistik.



Monument Natyre, Syri i Kaltër

E ka marrë këtë emër sepse forma e tij është ovale e ngjashme me formën e një syri, uji shpërthen nga toka e errët në mes dhe i kaltër anash. Thellësia e tij është tepër e madhe arrin deri në 45 m.

Ndodhet përballë fshatit Krongj, 45 m në nivelin e luginës së Drinos dhe është shkarkim kryesor i malit të gjerë. Është burim me ujëra të freskëta dhe të ëmbla i rrethuar me bimësi të dendur dhe me gjelbërim të përhershëm. I shëmbëllen vërtet një syri të madh rumbullak me diametër afro dhjetë metra.

Bebja e syrit, një gropë e thellë pus, nga ku uji ngjitet lart si në një kazan që sapo ka filluar të vlejë ka një ngjyrë blu në të zezë. Ajo vjen e rrethohet pastaj nga pjesa e kaltër e syrit që bëhet e tillë ngaqë thellësia e burimit aty është më e pakët. Gjithë uji i ëmbël i burimit rrethohet nga një bimësi e shumëllojshme.

Peizazh Natyror i Menaxhuar, Karaburun

Rezervati Natyror i Menaxhuar/Parku Natyror i Karaburunit. Sipërfaqja: 20 000 ha, lartësia mbi nivelin e detit: 0 – 1500 m; shpallja: 27.07.1977. Gadishulli i Karaburunit shtrihet midis detit Adriatik dhe Jon. Makja mesdhetare, me një përzierje interesante të rrënjës, ilqes dhe valanidhit mbulon pjesën më të madhe të shpateve. Zona përdoret masivisht për kullotje, aktiviteti i cili ka formësuar peizazhin. Linja bregdetare e Karaburunit formon gjire të vegjël dhe plazhe, të cilat janë përdorur që në kohët e lashta. Gjiri i Gramës, në bregun jugperëndimor të Karaburunit, tregon një prani gati 2000 vjeçare të shkrimeve latine dhe greke. Shpella të panumërta dhe të çara nëpër shkëmbinj janë habitate të rëndësishme për lakuriqët e natës dhe shpendët, midis të cilëve lajmëtari i madh i furtunës. Nëse planifikoni të eksploroni dhe të mrekulloheni nga Karaburuni, sigurohuni të merrni shumë ujë me vete dhe të visheni në mënyrë të përshtatshme. Gadishulli i Karaburunit është pjesë e site-it IBA me emrin Gjiri i

Vlorës-Gadishulli i Karaburunit, Mali i Cikës me një sipërfaqe 35.000 ha. Kjo zonë plotëson kriterin B2 të IBA dhe është një vend i rëndësishëm për shumimin e shpendëve

Peizazh Natyror i Menaxhuar, Vjosë - Nartë

Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë është një zonë e mbrojtur peizazhi në Shqipërinë Jugperëndimore. Ajo mbulon një sipërfaqe totale prej 194.12 kilometra², që përfshin lagunën e Nartës së bashku me grykëderdhjen e Vjosës dhe zonat përreth saj, me ligatinat e ujërave të ëmbla, moçalet, shtretërit e kallamishteve, tokat pyjore, ishujt dhe



plazhet me rërë. Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) e ka renditur parkun si Kategoria VI.

Parku është renditur gjithashtu edhe si një zonë e rëndësishme e shpendëve dhe bimëve, sepse mbështet specie të konsiderueshme të shpendëve dhe bimëve. Vjosa është konsideruar të jetë lumi i fundit i egër në Evropë, i cili buron në malet e Pindit në afërsi të kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Në veri të Lagunës së Nartës është një pellg ujëmbledhës, nga ku lumi derdhet në Detin Adriatik. Laguna e cekët e Nartës ndahet nga deti Adriatik me një breg të ngushtë rëre, i cili është i mbuluar me pyje pishe. Në të njëjtën kohë është e lidhur edhe përmes dy kanaleve artificiale me detin. E vendosur në afërsi të drejtpërdrejtë me detin Adriatik, në peizazh mbizotëron klima mesdhetare. Kjo do të thotë që dimrat janë të butë dhe verat janë të nxehta dhe të thata. Karakteri mesdhetar shënohet me shpërndarjen vjetore të reshjeve, të larta në muajt e dimrit dhe të moderuara në muajt e verës.



Parku Kombëtar i “Bredhit të Hotovës-Dangëlli”

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 26.1.2022 Parku Kombëtar i “Bredhit të Hotovës-Dangëlli”, u zgjerua me sipërfaqe 36 003.76 hektarë. Parku ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në verilindje të qytetit të Përmetit; në malësinë e Dangëllisë dhe të Shqipërisë dhe në lartësitë nga rreth 230m në 1,663m mbi nivelin e detit, në verilindje të lumit Vjosa.

Ky park është më i madhi i vendit dhe dallohet për vlera të larta të biodiversitetit. Formon një kurorë gjigante të gjelbër dhe për nga madhësia, të vetmin masiv pyjor në jug të vendit. Ndaj mund të cilësohet “mushkëria natyrore” e Shqipërisë Jugore. Pamja madhështore e parkut shpaloset befas nga hyrja e luginës së Lomnicës, deri afër malit të Kokojkës. Pylli me dominim të Bredhit të Maqedonisë, konsiderohet një nga reliket bimore mesdhetare më të rëndësishme në Shqipëri dhe një nga parqet më të mëdhenj në Ballkan me këtë bimë relikte.

Mjaft aktive janë shkëputjet tektonike në krahun e djathtë të sinklinalit të Përmetit dhe në lindje të antiklinalit Postenan-Melesin, me të cilët lidhen burimet e nxehta minerare në Bënjë dhe Vromoner dhe uujt minerarë në Postenan. Kjo zonë është e copëtuar nga një rrjet shumë i dendur hidrografik, degë të Osumit e të Vjosës. Lumi i Lengaricës, ndërpret tërthor malësinë e Dangëllisë dhe derdhet në Vjosë.

Janë evidentuar rreth 46 lloje të Gjitarëve, më të zakonshme janë: Ariu i murrmë, Ujku, Baldosa Shqartha, Larmia e përbërjes gjeomorfologjike, rrjeti ujor si dhe klima e parkut, kanë favorizuar prezencën e 15 tipave të habitateve natyror. Këtu vlen të theksohet prania e makies me Mëllagjeri, thujse i vetmi vend i saj në Shqipëri. Në park dhe afër tij ndodhen disa objekte dhe ndërtesa të rëndësishme kulturore e historike, që kanë marrë statusin e monumentit të kulturës.



Parku Kombëtar i Butrintit

qendra kryesore Arkeologjike e Butrintit, ndërsa përreth saj ka edhe monumente të tjera që dëshmojnë për qytetërim mbi 3000 vjeçar. Gjithashtu në brendësi të tij dhe afër tij ka disa monumente natyre me vlera shkencore, didaktike dhe turistike.

Një kombinim fantastik i mjedisëve detare, lumore, lagunore, fushore e kodrinore, ku janë mjaft të pranishme edhe elementet historike,



15
VITE NË
NATO



NATO
+
OTAN
75
YEARS
ANS

